



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0701

OSHP: 2024/0703

OSHP: 2024/ 0712

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Batisha Ibrahim-Kryesuese, Isa Hasani dhe Kimete Gashi-Brajshori- Anëtar të panelit shqyrtues duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “Virtuo O.P”., si dhe OE “Botek” shpk, OE “NOVUS” SH.P.K., kundër vendimit për anulimin e procedurës së prokurimit, të “Ministrisë së Shendetsisë”, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi, implementimi dhe mirëmbajtja e sistemit Packs dhe RIS të SISH” me numër të prokurimit 206-23-13309-1-1-1, me 15/10/2024, mori këtë:

Vendim

1. Aprovohen, si pjesërisht të bazuara ankesat e OE “Virtuo O.P”., me nr. 2024/0701, e datës 02/08/2024 ankesa e OE “Botek” shpk me nr. 2024/0703, e datës 02/08/2024, të AK “Ministrisë së Shendetsisë” lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi, implementimi dhe mirëmbajtja e sistemit Packs dhe RIS të SISH” me numër të prokurimit 206-23-13309-1-1-1. kurse oferta/tenderi i tij/sajë janë të papërgjegjshme lidhur me mosplotësimin e kërkesave të kapacitetit teknik dhe/ose profesional të NJT / Dosjes së tenderit.

2. Aprovohet si pjesërisht e bazuar ankesa e OE “NOVUS” SH.P.K., me nr.2024/0712 e dates 03/08.2024 kurse vendimi i AK “Ministrisë së Shendetsisë” lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi, implementimi dhe mirëmbajtja e sistemit Packs dhe RIS të SISH” me numër të prokurimit 206-23-13309-1-1-1, lënda kthehet në Riversim.

3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

4. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik “Virtuo O.P”., OE “Botek” shpk dhe “NOVUS” SH.P.K., 5. Në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimin të ankesës. OE ankues

obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 29.11.2023, “Ministrisë së Shëndetsisë” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi, implementimi dhe mirëmbajtja e sistemit Packs dhe RIS të SISH” me numër të prokurimit 206-23-13309-1-1-1.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës për furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 3,800.000.00 €.

Me 18.07.2024 AK ka publikuar Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues-B58 përmes të cilit edhe ka anuluar aktivitetin e prokurimit.

Me 22.07.2024, OE “Virtuo O.P”., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vlersimit të tenderve të Autoritetit Kontraktues. Me datë 22.07.2024 OE “NOVUS” SH.P.K., si dhe po ashtu me datën 23.07.2024 OE “Botek” shpk ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim të Autoritetit Kontraktues.

Me 26.07.2024, Autoriteti Kontraktues ka publikuar vendimin përmes të cilit ka refuzuar si të pa bazuara ankesat e të tre Operatorëve Ekonomik dhe vërtetohet njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues .

Me 02/08/2024, OE “Virtuo O.P”., ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 0701/2024 ndërsa me datë 02/08/2024 OE “Botek” shpk ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 0703/2024 ndërsa OE “NOVUS” SH.P.K., me datën 03/08/2024 ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 0712/2024.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se të dy ankesat i përmbajnë të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si të tilla janë parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatorët ekonomik që janë palë të interesuara sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetente për të shqyrtuar këto ankesa sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesave në mënyrë meritore.

Duke marrë parasysh faktin se të dy ankesat janë të ndërlidhura me aktivitetin e njëjtë të prokurimit përkatësisht me njoftimin mbi vendimin e njëjtë të Autoritetit Kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, është vendosur që ankesa nr. 0701/24 dhe ankesa nr. 0703/24 si dhe OE 712/24 të bashkohen dhe të trajtohen si rast i unifikuar në kuptim të nenit 16 paragrafit 1 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Virtuo O.P”., janë parashtruar si në vijim:

Ne si Grup I OE-se e kemi plotësuar sic duhet Formularin e paraqitjes së tenderit në E-prokurim, ashtu siq është e paraqitur në platformën elektronike të prokurimit. Kjo për shkak që ne si OE nuk kemi qasje që të bëjnë nderrime apo ndryshime mirepo duhet ndjekur hapat e procedurave të sistemit elektronik.

1. Samir Brackovic është PMP siq është kërkuar në dosjen e tenderit si dhe se ka kryer fakultetin Teknik dhe është inxhinjer në inxhinjerinë mekanike si dhe master në shkencat teknike dhe mekanike. Kërkesa e juaj ka qenë të jetë ekuivalente dhe me këtë në kemi plotësuar kërkesat tuaja si ekuivalente. Deri sa kjo I takon fakultetit Teknik dhe se ka lende të teknologjive informative në këtë fakultet. Të sqarojmë se të gjitha lëmitë në fakultetin Teknik sidomos ato të cilat janë komplekse janë të bazuara në teknologjinë e informimit pa parë parasysh se a janë elektro, mekanike apo ndërtim /arkitekture të gjithat janë kanë të bëjnë me lëminë e TI-se.

2. Ajdin Hukara ka përfunduar me sukses certifikimin pasi që trajnimi I mbajtur përmban edhe certifikimin (EXAM) në fund të kursit. Kërkesa e juaj për: i certifikuar në Menaxhimin e Sigurisë dhe Sistemeve për Windows, ose Linux dhe nuk ka qenë e specifikuar saktë siq janë kërkuar tjerat CCNP, CCNA etj. AK Ministria e Shëndetësisë në FTD të dosjes së tenderit ka kërkuar IT System Specialist me minimum 10 vjetë përvojë dhe certifikatë në Menaxhimin e Sigurisë dhe Sistemeve ndërsa në arsyetimin tuaj në vendimin e AK-se keni shkruar që Ajdin Hukara ka vetëm 1 certifikatë. Kjo bien ndesh me kërkesat e dosjes së tenderit pasi që nuk është kërkuar saktësisht sa certifikime duhet të posedojë apo cila certifikim kërkohet saktësisht. Por Ajdin Hukara posedon ende certifikatë tjera të cilat mundemi të ju dërgojmë të cilat është dashur që të i kerkoni në bazë të ligjit të Prokurimit nëni 69 I LPP-se.

3. Marko Maricic posedon Master certifikimin me 123 kredi e cila është me nivel me I lartë se bachelor dhe se për të marrë këtë certifikatë duhet të ketë një bachelor. Por në mund të ju sjellim edhe certifikatën e bachelor me 182 kredi.

4. Abdic Anes posedon certifikimin në platformën e zhvillimit Pack Systemit, prodhues ky që në kemi ofertuar me këtë brand.

5. Tarik Demirovic posedon certifikimin në platformën e zhvillimit të Pack Systemit, prodhues ky që në kemi ofertuar me këtë brand.

6. Vedat Zulic ka diplomë universitare fakultetin elektroteknik që është nivel me I lartë se bachelor dhe jo specialist profesional në teknologjinë informative që nuk qëndron ashtu.

Për vlerësimin është bërë jo korrekt nga ana e AK-se. Pretendimi I juaj se fakulteti elektroteknik është jo profesional është diskriminues dhe me vlerësim jo profesional sidomos kur merret parasysh se ju me këtë keni nëvlerësuar edhe fakultetin e Prishtinës.

7. Sanjin Elezovic ka të përfunduar Fakultetin për teknologjinë informative që është nivel me I lartë se bachelor dhe jo siq pretendoni ju specialist profesional dhe ka titull inxhinjer dhe me nëshkrim të rektorit. Është diskriminuese pretendimi juaj se fakulteti është joprofesional dhe se me këtë ky ka plotësuar kërkesën juaj bachelor shkencave kompjuterike.

8. Nijaz Hajdarovic ka të përfunduar fakultetin elektroteknik që është nivel me I lartë se bachelor dhe se nuk qëndron se titulli është akademik dhe jo profesional. Dhe është shumë e pakënjat nga

ana juaj.

9. Glauk Hoxha është pjesë e listës së inxhinjerve pasi që ne kemi përbushur për pjesën e inxhinjereve implementues prej 8 veta të cilët I kemi përbushur dhe se ne kemi shtuar edhe me shumë numrin e inxhinjerve për të implementuar projektin.

10. Goran Mitev është pjesë e ekspertëve të bazës së të dhënave. Në FTD të dosjes së tenderit janë kërkuar minimum 2 ndërsa ne kemi shtuar edhe Goran Mitev si pjesë e stafit. Goran Mitev është i paraqitur në Deklaratën: Lista e Inxhinjerve të caktuar për të zbatuar projektin.

Duhet cekur që AK Ministria e Shëndetësisë nuk ka kërkuar informata shtese lidhur me certifikatat dhe CV të stafit në bazë të Nenin 69 të LPP-së. Në rast të respektimit të këtij neni në si OE do të ju kishim dërguar edhe certifikimet përkatëse për secilin antar të stafit.

Duke u referuar të pretendimet si më sipër, OE “Virtuo O.P”., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 59, 69 të LPP-së si dhe neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve i RRUOP-së, Dispozitat e shkelura nga rregullorja me nr. 001/2022, për prokurim Publik Neni 43 - Ndërrprerja e procedurave të prokurimit Neni 97 - Shkeljet e rënda. Andaj kërkojmë nga ana e OSHP-së që Lenda të shkon në RIVLERESIM dhe që AK të bëjë Ekzaminimi dhe Vlerësimin e ofertes tone, të drejtë pa diskriminim i të gjitha kërkesave sipas dosjes së tenderit, duke respektuar të gjitha nenet e ligjit të prokurimit.

Përgjigje e AK në kërkesën për rishqyrtim për OE “Virtuo O.P”., përgjigje e Autoritetit Kontraktues në lidhje me pretendimet ankimore.

I konsiderojmë të pa bazuara pretendimet ankimore të operatoreve ekonomik: “VIRTUO OP”); Cactus sh.a.; GOE PACS & Workflow System; GOE Vepro & Botek, dhe qendrojmë pas Njoftimit mbi Vendimin e AK të datës 18.07.2024.

Ofertat janë të pa përgjegjshme nga aspekti administrativ i mosplotësimit si duhet të Formularit të paraqitjes së tenderit në e-prokurim, gjithashtu edhe për mos plotësim të Kërkesave mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, konkretisht nuk e kemi plotësuar dokumentacionin e kërkuar rreth stafit profesional, sipas detajeve të përshkruara në B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar, për secilin prej OE.

Sa i përket çështjes së Formularit të tenderit, gjatë Ri-tenderimit të këtij aktiviteti, AK-MSh do të ofroj shpjegime të karta, informata lidhur me plotësimin e kësaj pjesë, në formë të shembullit se si duhet të plotësohen nenkriteret e kërkuara dhe/ose të thjeshtohen kriteret e TEMF.

Gjithashtu gjatë Ri-tenderimit të këtij aktiviteti, AK-MSh do të caktoj konferencë paraofertuese me OE, ku do të shqyrtohen të gjitha pyetjet, kërkesat e OE, me qëllim që forma dhe specifikat e projektit të jenë sa më të kompletuar dhe të përfshihen të gjitha komponentet e nevojshme duke përfshirë edhe projeksionet për të ardhmen dhe inovacionet e duhura.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Botek” shpik janë parashtruar si në vijim:

Përmes kësaj Ankese, atakojmë vendimin e AK - Ministria e Shëndetësisë të datës 18.07.2024 për anulim të aktivitetit të prokurimit.

Së pari, duam të përmendim faktin se AK – Ministria e Shëndetësisë në Vendimin e tyre për Refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim nuk ka trajtuar pretendimet tona, duke shkelur kështu LPP

– Neni 108/A - pika 12. “Kundërshtimet dhe vendimet e miratuara në përputhje me paragrafët 8 dhe 10 të këtij neni, duhet të jenë të arsyetuara dhe ti komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë”, por vetëm ka ripërmendur dy arsye, për të cilat sipas tyre oferta jonë është e papërgjegjshme administrativisht, pa dhënë arsye të konkretë në pretendimet tona të paraqitura dhe faktura në Kërkesën për Rishqyrtim.

Ne deklarojmë se qëndrojmë në tërësi mbrapa të gjitha deklarimeve që kemi bërë në Kërkesën për Rishqyrtim, e të cilat po i shtjellojmë edhe njëherë në këtë ankesë, duke i faktuar edhe me prova materiale, sikurse kemi vepruar dhe në Kërkesën për Rishqyrtim.

Ne kundërshtojmë fuqishëm të gjitha pretendimet e AK-së si të pabazuara dhe vlerësojmë se ky Vlerësim/Vendim shkel Nenet 7 & 59 të LPP si dhe Piken 43 të Rregullores në fuqi.

Për me tepër, kemi dyshime të bazuara se bëhet fjalë për keqinterpretim të qëllimshëm të dokumenteve të dorëzuara me tender, dhe se vlerësimi nuk është i bazuar në LPP dhe vet Kërkesave në FDT si dhe Sqarimet shtesë nga MSH.

Njëkohësisht kemi dyshime të bazuara se dikush nga MSH, në këtë proces ka intervenuar në Formatin & Përmbajtjen e Raportit të Komisionit për Vlerësimin e Tenderit, pasi që kemi konstatuar Mospërputhje të dukshme në mes të Raportit të komisionit dhe Vendimit për Eliminimin e ofertës sonë!

Prandaj, ftojme Zyrtarët e MSH-së të cilët kanë qenë të involvuar në këtë procedurë/proces që gjatë procedurës së Rivlerësimit t'i evitojnë të gjitha këto mospërputhje dhe të eliminohen dyshimet se Raporti / Vendimi janë manipuluar.

Ju lutem, gjeni më poshtë të gjitha pretendimet e AK nga Letra Standarde për Tenderuesin e Eliminuar, në bazë të të cilave, oferta e grupit tonë, “qenka e papërgjegjshme administrativisht”, të cilat ne i kemi shtjelluar në Kërkesën Tonë për Rishqyrtim, duke paraqitur edhe prova për to:

1. Pretendimi i AK (MSH): “Nuk e keni plotësuar siç duhet Formularin e paraqitjes së tenderit në e-prokurim”.

Përgjigje në pretendimin 1. Ky konstatim i AK është i pabazuar dhe tendencioz ngase ne si OE/GOE, e kemi plotësuar Dosjen e Tenderit konkretisht Formularin për Dorëzimin e Tenderit, ashtu sikurse është kërkuar dhe ashtu sikurse parashihet me Manualin për OE- Përgatitja dhe dorëzimi i Ofertës.

Pasi që ne si OE / GOE të interesuar për të marr pjesë në këtë procedurë, kemi konstatuar se në "Manualin për OE - Përgatitja dhe dorëzimi i Ofertës? (Pëditësuar më 01/11/2022)", nuk sqarohet saktë se si saktësisht duhet të plotësohet ky formular, ne kemi kontaktuar KRPP – Helpdesk dhe kemi marr Instruksione të qarta se kjo pjesë duhet të plotësohet/përshkruhet Vlerat e Koeficientëve të Vlerësimit.

Për Ri-konfirmim, ne sërish kemi kërkuar Interpretim Ligjor nga KRPP me dt. 18.07.2024, dhe me dt. 22.07.2024, kemi pranuar të njëjtin Interpretim nga KRPP – Helpdesk, të cilin mund ta gjeni të bashkangjitur si Provë.

Pjesë nga Interpretimi i KRPP: “Ne raste të tilla, nga perspektiva e sistemit të prokurimit elektronik OE patjetër duhet të plotësojnë kolonën "Vlera e tenderit", meqenese nuk mund të

kalojne ne hapin tjetër, dhe ne lidhje me kete si shërbim i helpdeskut gjithmone udhezojme OE qe ne fushat e vleres se tenderit te pershkruajn vlerat e koeficienteve te peshimit.”

Prova 1 _ Interpretimi nga KRPP

2. “Ju e keni dërguar listën e stafit, të cilët disa prej tyre nuk i plotësojnë kriteret:

2.1. Pretendimi i AK (MSH): “Kastriot Fetahaj, pozita System Specialist. Ka ofruar disa certifikata per ndjekje te trajnimit mirepo jo edhe certifikime per Windows apo Linux”?.

Përgjigje në pretendimin 2.1: Specialisti i sistemit të cilin e kemi në listën e stafit Kastriot Fetahaj, përveç që ka një përvojë të gjatë në menaxhimin e sigurisë dhe sistemeve, posedon ndër të tjera dhe certifikimet: ISO/IEC 27032 Lead Cybersecurity Manager; ISO/IEC 27001 Lead Auditor; ISO/IEC 20000 Lead Implementer dhe ISO/IEC 27001 Provisional Auditor.

Më poshtë ju lutem gjeni të përmbledhura qëllimet për secilën ISO certifikatë që z. Fetahaj posedon, dhe të cilat ndërlidhjen me sistemet e ndryshme duke përfshirë edhe sistemet Windows dhe Linux. ISO/IEC 27032 është i fokusuar kryesisht në këto pika:

Kontrollet e Sigurisë Kibernetike: Kontrolle të përgjithshme që mund të aplikohen në lloje të ndryshme sistemesh, duke përfshirë sistemet operative si Windows dhe Linux.

Menaxhimi i Kërcënimeve dhe Vulnerabiliteteve: Identifikimi, analizimi dhe zbutja e kërcënimeve dhe vulnerabiliteteve që mund të ndikojnë në çdo sistem operativ.

Bazat e Sigurisë: Vendosja e bazave të sigurisë për sistemet IT, të cilat mund të përfshijnë sistemet operative Windows dhe Linux.

Përgjigja ndaj Incidenteve: Udhëzime për trajtimin dhe përgjigjen ndaj incidenteve të sigurisë kibernetike, të aplikueshme për çdo sistem, duke përfshirë sistemet operative.

Menaxhimi i Rrezikut: Praktikat e vlerësimit dhe menaxhimit të rrezikut që janë të rëndësishme për të gjitha llojet e mjediseve digjitale.

ISO/IEC 27001: është një standard ndërkombëtar për menaxhimin e sigurisë së informacionit. Qëllimi i një ISO/IEC 27001 Lead Auditor është të kryejë auditime të sistemit të menaxhimit të sigurisë së informacionit (ISMS) të një organizate për të siguruar që ai përputhet me kërkesat e standardit ISO/IEC 27001. Pra, ISO/IEC 27001 Lead Auditor siguron që një organizatë përputhet me standardin ndërkombëtar të sigurisë së informacionit duke përfshirë sistemet operative si Windows dhe Linux., janë të mbrojtura dhe menaxhuara në mënyrë efektive për të parandaluar dhe zbutur rreziqet e sigurisë.

ISO/IEC 20000: është një standard ndërkombëtar për menaxhimin e shërbimeve të IT (ITSM). Qëllimi i një ISO/IEC 20000 Lead Implementer është të udhëheqë dhe të mbështesë një organizatë në implementimin e një Sistemi të Menaxhimit të Shërbimeve (SMS) që përputhet me kërkesat e ISO/IEC 20000. Pra, një ISO/IEC 20000 Lead Implementer siguron që një organizatë implementon dhe menaxhon në mënyrë efektive një SMS që përputhet me standardin ndërkombëtar, (duke përfshirë sistemet operative si Windows dhe Linux) dhe duke siguruar që shërbimet e IT janë të mbrojtura, efektive dhe të disponueshme. ISO/IEC 27001: është një standard ndërkombëtar për menaxhimin e sigurisë së informacionit (ISMS).

Qëllimi i një ISO/IEC 27001 Provisional Auditor është të zhvillojë aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për të kryer auditime të sigurisë së informacionit sipas kërkesave të ISO/IEC 27001. Pra, një ISO/IEC 27001

Provisional Auditor synon të zhvillojë aftësitë dhe njohuritë për të kryer auditime të sigurisë së informacionit sipas standardit ISO/IEC 27001 dhe siguron që sistemet janë të siguruara dhe menaxhuara në përputhje me kërkesat e standardit.

Poashtu, i njeiti posedon dhe certifikatën për përfundim të trajnimit për mbrojtje të sistemit Windows: How It's Hacked, How to Protect It.

Prova 2_Certifikimet e Ekspertit; Kastriot Fetahaj

2.2. Pretendimi i AK (MSH): Albert Jashari, pozita Network admin. Ka ofruar disa certifikata per ndjekje te trajnimit, mirepo jo edhe certifikime sic eshte kerkuar ne dosjen e tenderit”?.

Përgjigje në pretendimin 2.2: Konstatimi i AK NUK është i bazuar, pasi që ne për këtë pozitë ne kemi ofruar Ekspertin; Albert Jashari, i përcaktuar nga ne si Network Admin për këtë projekt, dhe sikurse edhe është në cekur në CV e tij, i njëjti posedon certifikatën Cisco Networking Academy Advanced Level Instructor, me pervoje 15 Vjeçare, cila konsiderohet si kualifikim me i lartë se vet CCNA.

Pra ne kemi ofertuar Ekspertin me Certifikaten CCNA (nivel instruktori) (kërkesa. 9.1. & 9.2 të FDT) duke u bazuar në sqarimet e ofruara nga AK-MSH, me datë: 30.01.2024, ku specifikisht është lejuar Certifikaten CCNA si ekuivalente, citat: “Ne mund të pranojmë certifikimin CCNA si kërkesë minimale për këtë kërkesë” .

Prova 3_Sqarimet shitesë nga AK, dt. 30.01.2024; Prova 4_CV e Albert Jasharit; Prova 5_Certifikimet e Ekspertit, Albert Jashari. Për më tepër, sipas LPP-së, neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, paragrafi 2) Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues” Edhe me Udhëzimin për Prokurimin Publik, decidivisht lejohen sqarimet e Tenderit të dorëzuar duke mos bërë asnjë ndryshim në material.

Në këtë rast dhe secilin rast kur mungojnë apo ka paqartësi ne lidhje me Certifikatat e dorëzuara, AK mund të kërkojë sqarime shitesë nga OE / GOE, për të evaluuar në mënyrë të drejtë ofertën, pasi që një certifikatë e tillë si dokument ekzistues i dorëzuar bashkë me ofertën tonë, duhet të merret parasysh pas sqarimeve, pasi që NUK përbën asnjë ndryshim në material.

2.3. Pretendimi i AK (MSH): “Dardan Sojeva, pozita “Network expert”. Ka ofruar certifikate per ndjekje te trajnimit mirepo jo edhe certifikimet sic eshte kerkuar ne DT”.

Përgjigje në pretendimin 2.3: Dardan Sojeva, për këtë pozitë (kërkesë) është përcaktuar nga ne vetëm si staf shitesë në cilësinë ekspertit të rrjetit, pasi që për këtë kërkesë nga dosjë e tenderit ne kemi ofruar edhe

2 Expert të rrjetit me Certifikatat përkatëse (CCNP), Redon Hasanmetaj dhe Berat Buzoku, ashtu sikurse është kërkuar ne FDT dhe konsiderojm se ky (pretendim tendencioz) i AK, NUK është i

bazuar.

2.4. Pretendimi i AK (MSH), “Darko Jamnic, pozita Database expert. Nuk ka ofruar ndonje certifikim, gjithashtu ne CV nuk eshte cekur qe ka ndonje certifikim”?

Përgjigje në pretendimin 2.4: Darko Jamnic, i përcaktuar nga ne si ekspert i databazës, sikurse edhe është deklaruar në CV e tij, ka të përfunduar: MCSE Microsoft Certified Solution Expert-Data Management and

Analytics; MCSE Microsoft Certified Solution Expert- Data Platform; MCITP Microsoft Certified IT

Professional - Database Developer 2008; MCITP Microsoft Certified IT Professional – Database Administrator 2008. Pra nuk qëndron pretendimi i AK se në CV e tij nuk është cekur që ka ndonjë certifikim. Prova 6 CV e Darko Jamnic Prova 7. Transkripta e certifikimeve të Ztr. Darko Jamnic, e nxjerr nga Platforma online e Microsoft dhe disa nga Certifikatat Kryesore Microsoft”

Në mënyrë që AK të bëjë një evaluim më të drejtë të ofertës sonë, është i lejuar që të kërkojë sqarime shtesë, për dokumentet të cilat janë ekzistuese, sipas LPP-së (neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, paragrafi 2) Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues.

Pra, duke pas parasysh ofertën tonë të përgjegjshme, AK – Ministria e Shëndetësisë ka pasur dhe i ka të gjitha Instrumentet Ligjore dhe të gjitha autorizimet sipas LPP-së dhe Rregulloreve në fuqi, që të kërkojë sqarimet e nevojshme për të bërë evaluimin e drejtë të ofertës sonë, gjithmonë duke mos lejuar ndryshim të çmimit apo materialit.

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, Ankuesi “Botek” shpk konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 59, 72 dhe 108/A të LPP-së Pika 40 e RRPP-së - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve Pika 10 e Udhëzuesit Nr. 001/2023 për Prokurimin Publik – Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve. Prandaj, bazuar në ato që u tha më lart, si dhe në LPP, RRPP dhe UPP, kërkojmë nga Paneli Shqyrtues i OSHP-së, që të sjellë vendim meritore, me të cilin obligon AK- Ministria e Shëndetësisë që: Të anuloj Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 18.07.2024, Lëndën ta kthejë në rivlerësim.

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim për OE “Botek” shpk përgjigje e Autoritetit Kontraktues në lidhje me pretendimet ankimore.

“I konsiderojmë të pa bazuara pretendimet ankimore të operatoreve ekonomik: “VIRTUO OP”); Cactus sh.a.; GOE PACS & Workflow System; GOE Vepro & Botek, dhe qendrojmë pas Njoftimit mbi Vendimin e AK të datës 18.07.2024.

Ofertat janë të pa përgjegjshme nga aspekti administrativ i mosplotësimit si duhet të Formularit të paraqitjes së tenderit në e-prokurim, gjithashtu edhe për mos plotësim të Kërkesave mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, konkretisht nuk e kemi plotësuar dokumentacionin e kërkuar rreth stafit profesional, sipas detajeve të përshkruara në B42 Letër Standarde për

tenderuesin e eliminuar, për secilin prej OE.

Sa i perket çështjes së Formularit të tenderit, gjatë Ri-tenderimit të këtij aktiviteti, AK-MSh do të ofroj shpjegime të karta, informata lidhur me plotësimin e kësaj pjese, në formë të shembullit se si duhet të plotësohen nenkriteret e kërkuara dhe/ose të thjeshtohen kriteret e TEMF.

Gjithashtu gjatë Ri-tenderimit të këtij aktiviteti, AK-MSh do të caktoj konference paraofertuese me OE, ku do të shqyrtohen të gjitha pyetjet, kërkesat e OE, me qëllim që forma dhe specifikat e projektit të jenë sa më të kompletuar dhe të përfshihen të gjitha komponentet e nevojshme duke përfshirë edhe projektionet për të ardhmen dhe inovacionet e duhura”.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “NOVUS” SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

OE PACS and Workflow System ka pranuar Vendimin në bazë të cilit është refuzuar Kërkesa për Rishqyrtim. Megjithatë Vendimi, nuk ka adresuar asnjërin nga çështjet e ngritura nga ana e OE PACS and Workflow System duke theksuar se asnjëra nga palët ankuese nuk kanë ofertuar përgjegjshëm dhe në këtë drejtim anulohet tenderi i publikuar.

Në këtë drejtim në pjesën e Arsytimit ka theksuar se në ri-tenderim do të caktoj konferenca dhe jep sqarime shtesë këtu duke pranuar që nuk kanë sqaruar si duhet tenderin edhe pse ofertat kanë qenë në linjë sipas atyre të publikuara dhe me rregulloret e aplikueshme të prokurimit public. .

Në këtë drejtim pretendimet Ankimore në këtë Ankesë pranë OSHP-së, vazhdojnë të jenë të njëjtat sikurse ato të Kërkesës për rishqyrtim të cilat kanë mbetur të adresuara nga ana e AK-së.

Në kundërshtim të kësaj, OE PACS and Workflow System paraqet pretendimet si në vijim: (1) OE PACS and Workflow System ka plotësuar të gjitha pjesët obligative të Dosjes së Tenderit

(a) OE PACS and Workflow System ka paraqitur ofertë të përgjegjshme

(b) Nuk janë plotësuar kushtet ligjore që të anulohet aktiviteti i prokurimit

Pretendimi ankimor 1: OE PACS AND WORKFLOW SYSTEM KA PLOTËSUAR TË GJITHA PJESËT OBLIGATIVE TË DOSJES SË TENDERIT

AK ka konsideruar ofertën e OE PACS and Workflow System për shkak se nuk dhënë përgjigje në lidhje me Kriteret për Dhënie të Kontratës nga Aneksi 6 i Dosjes së Tenderit. Këto pjesë të Dosjes së Tenderit, nuk parashihen të plotësohen nga OE, dhe se as sistemi online “e-prokurimi” nuk i ka paraparë si pjesë obligative për plotësim. Më konkretisht as nga vetë Autoriteti Kontraktues nuk ka pasur sqarime dhe detaje se nëse kjo pjesë duhet të plotësohet dhe se si duhet të plotësohet. Kjo veqse është konfirmuar edhe nga vete AK në përgjigjen tone ndaj kërkesës për rishqyrtim, ku ka theksuar se gjatë ri-tenderimit të këtij aktiviteti të prokurimit do të jete sqarime dhe detaje se si duhet të plotësohet kjo pjese nga Operatorët Ekonomike të interesuar për pjesëmarrje.

Për më tepër, është e paqartë se çfarë është dashur të plotësoj në këto pjesë OE PACS and Workflow System, pasi që Aneksi 6 i Dosjes së Tenderit është vetëm informatë obligative që duhet të përmbajë një Dosje e Tenderit, sipas nenit 27, paragrafit 1 të LPP-së, Nenit 17.22.1 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, si dhe Pikës 3.7. të Udhëzuesit Nr. 001/2023 për Prokurimit Publik. Por jo si pjesë e cila duhet të plotësohet nga OE.

Prandaj, oferta e OE PACS and Workflow System në këto pjesë ka përshkruar vetëm “N/A”, pasi që këto pjesë nuk janë për plotësim nga OE. Përkatësisht, oferta e OE PACS and Workflow System, nuk mundet të vlerësohet si mospajtueshmëri me kriteret administrative dhe teknike sipas Nenit 40, paragrafit 6 dhe 7 të Rregullores Nr. 001/2022, për shkak të lëshimeve të AK-së. Prandaj AK në këto rast nuk mund të merr vendim që OE PACS and Workflow System është i papërgjegjshëm pasi që nuk ka plotësuar formularin e tenderit siq duhet, duke qenë se vetë nuk ka dhënë sqarime se a duhet dhe se si duhet të plotësohet kjo pjesë.

Pretendimi ankimor 2: OE PACS AND WORKFLOW SYSTEM ka paraqitur ofertë të përgjegjshme OE PACS and Workflow System ka paraqitur ofertë e cila i plotëson të gjitha kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale nga pika 9.1. & 9.2. e Seksionit II - Fleta e të dhënave të Tenderit (FTD), të DT. Një fakt i tillë dëshmohet nga dokumentet që OE në fjalë i ka dorëzuar me rastin e paraqitjes së ofertës.

Në lidhje me kriteret e stafit, DT, përkatësisht “Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2”, ndër të tjera, ka listuar pozitat për stafin e OE si në vijim:

Kërkesa: Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Menaxher i projektit IT me një eksperiencë minimale prej 10 vitesh në menaxhimin e projekteve të ngjashme, i certifikuar në menaxhimin e projekteve dhe me diplomë minimale bachelor në fushat e IT (“Menaxher i projektit IT”); Kopje CV me të gjitha detajet, diplomën dhe certifikatat e kërkuara.

2. Administrator i rrjetit me një eksperiencë minimale prej 8 vitesh në projekte të ngjashme ose në projekte IT me kompleksitet të ngjashëm, minimalisht i certifikuar në CCNP ose ekuivalent dhe me diplomë minimale bachelor në fusha IT (“Network Administrator”). Kopje CV me të gjitha detajet, diplomën dhe certifikatat e kërkuara.

3. Dy (2) Ekspertë Rrjeti me një eksperiencë minimale prej 8 vitesh në projekte të ngjashme ose në projekte IT me kompleksitet të ngjashëm, minimalisht të certifikuar në të paktën një Certified Sigurie CCNP dhe një CCNP Datacenter Certified ose ekuivalent dhe me diplomë minimale bachelor në fusha të IT (“Network Expert”). Kopje CV me të gjitha detajet, diplomën dhe certifikatat e kërkuara.

4. Së paku tetë (8) anetar, të ndarë në katër (4) ekipe implementuese, me një eksperiencë minimale prej 5 vitesh në projekte të ngjashme, me diplomë minimale bachelor në fushat e IT (“Staf Implementues”). Kopje CV me të gjitha detajet, diplomën dhe certifikatat e kërkuara.

OE PACS and Workflow System ka plotësuar të gjitha kriteret, duke ofruar numër të stafit të kualifikuar. OE ka ofruar edhe staf shtesë, i cili kalon numrin e kërkuar sipas Dosjes së Tenderit. Pavarësisht kësaj, AK pretendon se stafi në vijim nuk i plotëson kriteret sipas komenteve:

1. Biljana Droshanova e vendosur nga OE PACS and Workflow System për pozitën Menaxher i Projektit IT: “Është ofruar certifikate me titull profesional të fituar dhe jo siç është kërkuar titull akademik bachelor”;

2. Muhamed Gërzhaliu i vendosur nga OE PACS and Workflow System si staf suportues shtesë për Menaxherin e Projektit IT: “Nuk ka ofruar certifikime në CCNA siç është kërkuar në DT”;

3. Bahrije Vardari e vendosur nga OE PACS and Workflow System si staf suportues shtesë për Ekspertët e Rrjetit: “Nuk ka ofruar diplomë bachelor siç është kërkuar në DT”;

4. Jadranka Velinska e vendosur nga OE PACS and Workflow System si pjesë e Ekipeve Implementuese: “Ka ofruar vetëm certifikatën e notave por jo edhe diplomën siç është kërkuar”.

2.1. Përmbushja e Kërkesës për Menaxher të Projektit IT Fillimisht, në lidhje me pozitën e Menaxherit të Projektit IT, Znj. Biljana Droshanova plotëson të gjitha kriteret e caktuara nga DT, përkatësisht në lidhje me titullin akademik bachelor. Për të vërtetuar këtë, OE PACS and Workflow System, në ofertën e tij ka bashkangjitur dokumentin si në vijim:

1. Certifikata Nr. 09/03/53 për studime bachelor në fushën e Elektronikës dhe Telekomunikacionit, e lëshuar nga Universiteti “Ss Cyril and Methodius University” në Shkup, me datën 01 prill 2004, për Znj. Biljana Droshanova (“Certifikata Nr. 09-3/53”).

Prova 1: Certifikata Nr. 09-3/53 e lëshuar nga Ss Cyril and Methodius University - Skopje, e datës 01.04.2004.

2.2. Përmbushja e Kërkesës për Network Administrator

Sipas Dosjes së Tenderit, OE i është dashur të ketë vetëm një person në stafin e tij në pozitën e Network Administrator. OE PACS and Workflow System në ofertën e tij ka siguruar dy persona në këtë pozitë ka vendosur z. Bojan Nikolovski dhe z. Muhamed Gërxfhaliu. AK ka gjetur se për shkak se z. Muhamed Gërxfhaliu nuk është ofruar certifikime në CCNA, oferta e OE PACS and Workflow System është e papërgjegjshme, ndërsa për z. Bojan Nikolovski, AK ka vërtetuar se i njëjti plotëson kërkesën sipas DT.

Oferta e OE PACS and Workflow System është përgjegjshme pasi që vetëm me z. Bojan Nikolovski, është plotësuar kërkesa mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2, nga Dosja e Tenderit, për stafin në pozitën e Network Administrator. Ndërkohë, Z. Muhamed Gërxfhaliu ishte vendosur nga OE PACS and Workflow System si vlerë e shtuar për Z. Nikolovski. Mirëpo, Z. Gërxfhaliu nuk është stafi kryesor për pozitën në fjalë. Rrjedhimisht, AK nuk është dashur ta konsideroj këtë kërkesë të DT si të pa plotësuar. Prova 2: Curriculum Vitae dhe dokumentet mbështetëse të Z. Bojan Nikolovski. 2.3. Përmbushja e Kërkesës për Network Expert

Ngjajshëm sikurse për kërkesën për Network Administrator, OE PACS and Workflow System ka ofruar numër më të madh të stafit se sa që është kërkuar, përkatësisht nga kërkesa për dy persona staf në këtë pozitë, OE PACS and Workflow System ka ofruar tre persona nga të cilët dy plotësojnë kërkesën nga DT.

OE PACS and Workflow System në ofertën e tij ka listuar Z. Genc Jakupi dhe Z. Nikolche Davchevski, të cilët plotësojnë të gjitha kushtet dhe kriteret e kërkuara nga DT, të cilët po ashtu janë konfirmuar nga AK për plotësimin e tyre. Znj. Bahrije Vardari ishte vendosur nga OE PACS and Workflow System vetëm si staf shtesë e cila do të mbështetë punën e dy Ekspertëve të konfirmuar të Rrjetit, por plotësimi i kushteve për të cilën nuk është vendimmarrëse për AK. Si rrjedhojë, pozitat e Network Expert janë plotësuar. Prova 3: Curriculum Vitae dhe dokumentet mbështetëse të Z. Genc Jakupi dhe Z. Nikolche Davchevski.

2.4. Përmbushja e Kërkesës për Staf Implementues

Së fundmi, në lidhje me Ekipet Implementuese, OE PACS and Workflow System ka paraqitur 10 persona, e cila fillimisht plotëson kushtin e “së paku tetë (8) persona” për Ekipet Implementuese. Mirëpo, AK thirret në mungesën e pretenduar të diplomës së znj. Jadranka Velinska, e cila ishte vendosur si pjesë e Ekipeve Implementuese. Dokumenti i vendosur për znj. Velinska ishte Certifikata e cila dëshmon diplomimin e saj në Ss, Cyril and Methodius University në Shkup, e cila lexon se “The student graduated on 25.05.2017, fulfilled all obligations from the study program (...) and acquired the right to professional title: ICT ENGINEER – SOFTWARE ENGINEERING.” (në shqip: Studenti i diplomuar me 25.05.2017, përmbushi të gjitha obligimet e programit studimor (...) dhe morri të drejtës për titullin profesional: Inxhinier - Inxhinier i Softuerit”). Andaj, kjo certifikatë nuk paraqet vetëm transkriptën e notave por dëshmon edhe diplomimin e znj. Velinska. Prova 4: Certifikata Nr. 10-1226/1 e lëshuar nga Ss Cyril and Methodius University - Skopje, e datës 29.05.2017.

Edhe po qe se znj. Velinska-së do i mungonte dokoumentacioni i nevojshëm, kjo nuk do të ndikonte në plotësimin e kushteve të përcaktuara në DT, e cila kërkon së paku 8 persona, përderisa OE PACS and Workflow System ka pasur të konfirmuar plotësimin e kushteve nga 9 persona të tjerë.

Pra, rezulton se nuk qëndrojnë pretendimet e AK se OE PACS and Workflow System nuk ka plotësuar kushtet dhe kriteret për stafin siç është përcaktuar sipas DT.

Në këtë drejtim, rezulton se oferta e OE PACS and Workflow System i plotëson të gjitha kërkesat dhe kriteret e përcaktuara nga AK dhe, si e tillë, konsiderohet ofertë e përgjegjshme. Ofertat e përgjegjshme, ndërkaq, duhet të shpërblehen me kontratë.

Prandaj, rezulton se eliminimi i OE në fjalë nga aktiviteti i prokurimit si i papërgjegjshëm, nga ana e AK, rezulton se është bërë në mënyrë të kundërligjshme.

Rrjedhimisht, Vendimi i AK për eliminim të OE PACS and Workflow System duhet të anulohet si i kundërligjshëm.

Pretendimi ankimor 3: NUK JANË PLOTËSUAR KUSHTET LIGJORE QË TË ANULOHEK AKTIVITETI I PROKURIMIT Neni 62 i LPP-së shprehimisht ka përcaktuar shkaqet për të cilat mund të përfundohet një aktivitet i prokurimit. Duke qenë se oferta e PACS and Workflow System është e përgjegjshme, nuk plotësohen kushtet për anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Kjo përkundër se, siç kemi elaboruar edhe më sipër, OE PACS and Workflow System ka dorëzuar ofertë të përgjegjshme dhe ekonomikisht të favorshme - me çmim nën vlerën e parashikuar nga AK.

Në raste të tilla, kur dorëzohet një ofertë e përgjegjshme dhe e cila i plotëson të dy kriteret vendimtare për t’u shpërblyer me kontratë, AK nuk mund të përfundojë aktivitetin e prokurimit, por duhet ta shpërblejë me kontratë OE që dorëzon një ofertë të tillë.

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, Ankuesi “NOVUS” SH.P.K., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 dhe 62 të LPP-së. Përfundimisht, bazuar në të lartcekurat, me respekt, kërkojmë nga AK që, pas shqyrtimit të kësaj Kërkese, të merr: **VENDIM TË APROVOHET** në tërësi si e bazuar ANKESA e paraqitur nga Operatori Ekonomik PACS and Workflow System. te **ANULOHEN** Vendimi i Autoritetit Kontraktues Ministria e Shëndetësisë, i datës 18.07.2024, për anulim të aktivitetit të prokurimit, dhe Letra Standarde për

tenderuesin e eliminuar, e datës 22.07.2024, për eliminimin e OE PACS and Workflow System nga ky aktivitet i prokurimit.

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim për OE “NOVUS” SH.P.K., përgjigje e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me pretendimet ankimore. “I konsiderojme të pa bazuara pretendimet ankimore të operatoreve ekonomik: “VIRTUO OP”); Cactus sh.a.; GOE PACS & Workflow System; GOE Vepro & Botek, dhe qendrojme pas Njoftimit mbi Vendimin e AK të datës 18.07.2024.

Ofertat janë te pa pergjegjshme nga aspekti administrativ i mosplotesimit si duhet te Formularit te paraqitjes së tenderit ne e-prokurim, gjithashtu edhe për mos plotësim te Kërkesave mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, konkretisht nuk e keni plotësuar dokumentacionin e kërkuar rreth stafit profesional, sipas detajeve te përshkruara ne B42 Letër Standarde për tenderuesin e eleminuar, për secilin prej OE.

Sa i perket çeshtjes se Formularit te tenderit, gjate Ri-tenderimit te ketij aktiviteti, AK-MSh do te ofroj shpjegime te kjarta, informata lidhur me plotesimin e kesaj pjese, ne forme te shembullit se si duhet te plotesohen nenkriteret e kerkuara dhe/ose te thjeshtohen kriteret e TEMF.

Gjithashtu gjate Ri-tenderimit te ketij aktiviteti, AK-MSh do te caktoj konference paraofertuese me OE, ku do te shqyrtohen te gjitha pyetjet, kerkesat e OE, me qellim qe forma dhe specifikat e projektit te jene sa me te kompletuar dhe te perfshihen te gjitha komponentet e nevojshme duke perfshire edhe projektionet per te ardhmen dhe inovacionet e duhura”.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shyrtues i Prokurimit me datë 19.08.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0701/2024 ndërsa me datë 16.08.2024 Paneli Shqyrtues ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0703/2024. Ndërsa me datën 19.08.2024 Paneli Shqyrtues ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0712/2024.

Lidhur me ankesën nr. 0701/24 me datë 02.09.2024 është dorëzuar raporti i ekspertin shqyrtues me nr. 2024/0701 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në vlerësimet dhe konstatimet e lartcekura, Ekspertit Shqyrtuesi i rekomandon Panelit Shqyrtues që ankesën e operatorit ekonomik ankues “Virtuo OP” ta aprovojë pjesërisht të bazuar (për arsyen e parë të eliminimit), kurse oferta/tenderi i tij/sajë të shpallet si e papërgjegjshme lidhur me mosplotësimin e kërkesave të kapacitetit teknik dhe/ose profesional të dosjes së tenderit.

Lidhur me ankesën nr. 0703/24 me datë 30.08.2024 është dorëzuar raporti i ekspertin shqyrtues me Nr. 2024/0703 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në vlerësimet dhe konstatimet e lartcekura, Ekspertit Shqyrtuesi i rekomandon Panelit Shqyrtues që ankesën e operatorit ekonomik ankues “Botek Sh.p.k.” ta aprovojë pjesërisht të bazuar (për arsyen e parë të eliminimit), kurse oferta/tenderi i tij/sajë të shpallet si e papërgjegjshme lidhur me mosplotësimin e kërkesave të kapacitetit teknik dhe/ose profesional të dosjes së tenderit.

Lidhur me ankesën nr. 0712/24 me datë 03.09.2024 është dorëzuar raporti i ekspertin shqyrtues me Nr. 2024/0712 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në vlerësimet dhe konstatimet e lartcekura, Ekspertit Shqyrtuesi i rekomandon Panelit Shqyrtues që ankesën e operatorit ekonomik ankues OE “PACS and Workflow System” ta aprovojë plotësisht të bazuar, kurse

Vendimi i AK-së i datës 18.07.2024 së bashku me letrën standarde për tenderuesin e eliminuar OE ankues, të Anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit të kthehet në Ri-vlerësim në raport me ankuesin OE “PACS and Workflow System”.

Raportin e ekspertizës me nr.0701/24 e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaroi se pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE nuk pajtohet rreth raportit të ekspertit shqyrtues.

Raportin e ekspertizës me nr.0703/24 e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaroi se pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE nuk pajtohet rreth raportit të ekspertit shqyrtues.

Raportin e ekspertizës me nr.0712/24 e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk ka kthyer përgjigje rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE pajtohet rreth raportit të ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore lidhur me rastin.

-Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit shqyrtues, parashtresat dhe dokumentet e ankuesve, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “Virtuo O.P.” eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/0701 ka vlerësuar si në vijim:

Me datën 29.11.2023, Ministria e Shëndetësisë, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi, implementimi dhe mirëmbajtja e sistemit Packs dhe RIS të SISH” numër prokurimi 206-23-13309-1-1-1, sipas të cilit dita e fundit e afati i fundit për dorëzimin e ofertave ka qenë data 01.02.2024. Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 3,800,000.00 €.

Kurse me datë 18.07.2024, ka komunikuar përmes sistemit elektronik të prokurimit Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – B58 për anulim të aktivitetit të prokurimit të cituar si më sipër. Këtij vendimi iu janë bashkëngjitur edhe letrat standarde për tenderuesit e eliminuar, pjesëmarrës në këtë aktivitet.

Me datën 22.07.2024 OE “Virtuo O.P.” kishte parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të njëjtë të AK-së, të cilën AK e ka refuzuar si të pa bazuar me Vendimin e AK të datës 26.07.2024.

Me datën 02.08.2024, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar (në sistemin elektronik) ankesën e operatorit ekonomik “Virtuo O.P.” (evidentuar me numër protokoll 701/24), kundër vendimit të cituar si më sipër të AK.

- Vlerësimet dhe gjetjet e ekspertit shqyrtues lidhur me ankesën e OE “Virtuo O.P” -

Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ngritura në ankesën e operatorit ekonomik të cekur më sipër dhe me këtë rast konform vlerësimin të pavarur dhe profesional sipas përgjegjësive të tij ligjore në kuptim të nenit 113 dhe 114 të LPP-së lidhur me nenin 17 dhe 19 të Rregullores, paraqet vlerësimet dhe të gjeturat si në vijim:

Bazuar në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar, eksperti sqaron se, ankuesi OE “Virtuo O.P” është eliminuar nga procesi i prokurimit me arsyetimin se nuk e ka plotësuar formularin e paraqitjes së tenderit në platformën elektronike (e-prokurim) ashtu siç është kërkuar në dosjen e tenderit, duke ju referuar pjesës në nenin 31.1 të Kriteret e dhënies (tenderi i përgjegjshëm ekonomikisht më i favorshëm..) ku ishte kërkuar nga OE që gjate përgatitjes së formularit të tenderit në platformën elektronike, të plotësojnë të gjitha nen-kriteret e TEMF, në të kundërtën, mosplotësimi i formularit të tenderit si duhet do të shpije në eliminim të tenderit. Në të njëjtën Letër, AK e ka informuar OE ankues se i njëjti nuk i ka plotësuar konform kriterëve të dosjes së tenderit kërkesat e kapacitetit profesional lidhur me një pjesë të stafit që janë prezentuar në listën e stafit, duke dhënë një arsyetim konkret për secilin veç e veç se pse nuk e ka plotësuar kërkesën përkatëse të dosjes së tenderit. Shihni ju lutem pjesën e arsytimit nga letra standarde e lartcekur.

Ankuesi (me të dhëna si më sipër) ka atakuar vendimin e AK për anulimin e aktivitetit të cituar si më sipër nga aspekti i eliminimit të tij/sajë, në pretendimin e parë lidhur me mosplotësimin kinse siç duhet të formularit të paraqitjes së tenderit në e-prokurim, dhe në pretendimin e dytë përmes pohimeve të specifikuar në 10 pika të kësaj ankese lidhur me atakimin e arsytimit të dhënë në letrën standarde për eliminimin e tij për shkak të mosplotësimin e kriterëve të stafit profesional sipas kërkesës së kapacitetit teknik dhe/ose profesional të dosjes së tenderit, për të cilat eksperti shqyrtues konsideron se nuk ka nevojë që të njëjtat të përshkruhen në detaje ose më gjerësisht në këtë rast, por do të prezentohen shkurtimisht për nevojat e vlerësimin të ekspertizës përderisa të njëjtat në aspektin e tërësishëm janë përshkruar në pjesën përkatëse të lartcekur të kësaj ekspertize. Andaj duke u bazuar në përshkrimin e pretendimve ankimore, eksperti shqyrtues sqaron se kemi gjetur se ankesa bazohet në a dy çështje kryesore:

- eliminimin për mosplotësimin siç duhet të formularit të paraqitjes së tenderit në e-prokurim, dhe
- eliminimin për mosplotësimin e kërkesave të kapacitetit teknik dhe/ose profesional lidhur me stafin profesional.

Eksperti shqyrtues, pasi i ka krahasuar të gjitha pohimet e pretendimeve ankimore në aspektin analitik në raport me arsyet e eliminimit të tij/sajë, dhe nga ana tjetër duke e analizuar dosjen e tenderit si dhe dokumentet me të cilat ka ofertuar ankuesi si GOE në raport me kushtet dhe kërkesat e dosjes së tenderit dhe të gjitha shkresat tjera në tërësinë e tyre, gjithashtu duke ju referuar dispozitave përkatëse të LPP-së dhe legjislacionit dytësor për prokurim publik, eksperti jep konstatimin dhe vlerësimin e tij sipas arsytimit të detajuar si poshtë

Pretendimi i parë (I): Lidhur me arsyen vendimtare të eliminimit të tij në të cilin thuhet, “nuk e keni plotësuar siç duhet formularin e paraqitjes së tenderit në e-prokurim” duke ju referuar situatës të kriteret e dosjes së tenderit të neni 31. 1 në dosjen e tenderit, OE ankues pretendon se si GOE e kanë plotësuar siç duhet Formularin e paraqitjes së tenderit në e-prokurim ashtu siq është e paraqitur në platformën elektronike të prokurimit duke ndjekur hapat e procedurave të

sistemit elektronik.

Vlerësimi i ekspertit shqyrtues lidhur me pretendimin e parë (I): Eksperti shqyrtues, pas analizimit dhe vlerësimit të pohimeve të OE ankues në raport me dosjen e tenderit dhe dokumentet me të cilat ka ofertuar së bashku anëtarët tjerë të GOE, të cilat mund të verifikohen lehtësisht nga dokumentacioni i prokurimit në e-prokurim, duke u mbështetur në dispozitat relevante të LPP-së si ligj material i zbatueshëm, legjislacionit dytësor për prokurim publik, Rrpp nr. 001/2022, ka gjetur se qëndron i bazuar pretendimi i OE ankues, për faktin se gjetjet tregojnë se OE ankues e ka plotësuar formularin e paraqitjes së tenderit në e-prokurim ashtu siç është përcaktuar në dosjen e tenderit të Kriteret e dhënies (tenderi i përgjegjshëm ekonomikisht më i favorshëm i përcaktuar sipas kriterit të peshës së nën-kritereve të përshkruara Aneksin 6) të nenit me nr. 31.1 të DT, duke ja mundësuar AK-së për të pasur njohuri të sakta për vlerësimin e ofertës të OE ankues pa kërkuar informata shtesë.

Ky konstatim i ekspertit shqyrtues mund të konfirmohet përmes dokumenteve relevante të dosjes së OE ankues lidhur me kriteret dhe nënkriteret e TEMF për dhënien e kontratës që i referohen Aneksit 6 të dosjes së tenderit përfshirë edhe ofertën financiare. Krahas këtyre, vlerësimi i ekspertit shqyrtues në kontesktin analitik mbështetet edhe në bazë të interpretimit ligjor të KRPP të dt. 18.07.2024 dhe dt. 22.07.2024 që ju ka ofruar një OE tjetër ankues në këtë aktivitet për situatën e njejtë. Shihni ju lutem pjesën e shkoqitur nga interpretimi i KRPP-së i cili thotë “Ne raste të tilla, nga perspektiva e sistemit të prokurimit elektronik OE patjeter duhet të plotësojë kolonen "Vlera e tenderit", meqenese nuk mund të kalojnë në hapin tjetër, dhe në lidhje me këtë si shërbim i helpdeskut gjithmone udhezohje OE që në fushat e vlerësimit të tenderit të përshkruajn vlerat e koeficienteve të peshimit.”

Për më tepër ekspertit shqyrtues sqaron se sipas legjislacionit të prokurimit publik duke përfshirë edhe Manualin për OE – Përgaditja dhe dorëzimi i ofertës, i publikuar në uebfaqe të KRPP-së, nuk parasheh informata, shpjegime/udhëzime dhe karakteristika të tilla funksionale të tilla (dëshirueshme) të plotësimit të formularit siç aludon AK-ja, duke qenë se këto kriteret dhe nën-kriteret relevante për lëndën e kontratës që përcaktohen me peshë sipas rëndësisë së tyre relative, përmbushen ose jo me dokumente specifike si në rastin konkret.

Prandaj duke u nisur nga ky vlerësim analitik i shpjeguar si më lart, ekspertit shqyrtues vlerëson se arsyetimi i eliminimit në këtë pikë i dhënë në letrën standadre për OE ankues nuk është në përputhje me nenin 59 të LPP-së dhe dispozitat tjera relevante të këtij ligji dhe legjislacionit dytësor të prokurimit publik që parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, për faktin se nuk është në interes të parimeve të ligjshmërisë të LPP-së të përcaktohen praktika të gabuara duke bërë zbatim jo adekuat të ligjit. Për këto arsye, ekspertit shqyrtues konstaton se ky pretendim është i bazuar.

Pretendimi i dytë (II): Lidhur me arsyen e dytë të eliminimit për shkak të mosplotësimit të Kërkesave mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale lidhur me stafin profesional, OE ankues përmes pohimeve të specifikuar në 10 pika të kësaj ankese përkitazi me dëshmitë për stafin e ofruar (Samir Brackovic, Ajdin Hukara, Marko Maricic, Abdic Anes, Tarik Demirovic, Vedad Zulic, Sanjin Elezovic, Nijaz Hajdarovic, Glauk Hoxha dhe Goran Mitev) pretendon se i kanë përmbushur kërkesat konform dosjes së tenderit.

Vlerësimi i ekspertit shqyrtues lidhur me pretendimin e parë (II): Eksperti shqyrtues, pas analizimit dhe vlerësimit të pohimeve të OE ankues në raport me dosjen e tenderit dhe dokumentet me të cilat ka ofertuar së bashku anëtarët tjerë të GOE, të cilat mund të verifikohen

lehtësisht nga dokumentacioni i prokurimit në e-prokurim, ka gjetur se nuk qëndron i bazuar pretendimi i OE ankues, për faktin se gjetjet tregojnë se oferta/tenderi i paraqitur nga OE ankues nuk i ka përmbushur kriteret minimale dhe të nevojshme të kapacitetit teknik dhe/ose profesional të parashtruara në kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, për shkak se dokumentacioni i ofruar nga OE ankues nuk përputhet me kriteret e specifikuar në secilën nga kërkesat kërkesat/dëshmitë e kërkuara dokumentare të kriterit të lartcekur (kapacitetit profesional) të dosjes së tenderit. Nga ky aspekt, eksperti shqyrtues konstaton se arsyeja e eliminimit në këtë pikë qëndron pasi që vlerësimi i ofertës së tij është bërë në përputhje me nenin 59 të LPP-së dhe legjislacionit dytësor për prokurim publik, në përputhje me nenin 40 të Rregullorës për Prokurimin Publik nr. 001/2022, për faktin se oferta/tenderi i OE ankues nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat e parashtruara në dosjen e tenderit, për arsyet e detajuara më poshtë:

- Lidhur me kërkesën e DT “Menaxher i projektit IT me një eksperiencë minimale prej 10 vitesh në menaxhimin e projekteve të ngjashme, i certifikuar në menaxhimin e projekteve dhe me diplomë minimale bachelor në fushat e IT”, eksperti vlerëson se, OE ankues nuk e ka përmbushur kërkesën përkatëse të dosjes së tenderit për faktin se nuk ka dorëzuar diplomën siç është specifikuar në kërkesën e dosjes së tenderit. Për faktin se diploma (Samir Brackovic) e ofruar nga OE nuk përputhet me kërkesën specifike të dosjes së tenderit për një diplomë në fushat e IT, si dhe nuk është ekuivalente dhe/ose e barasvlefshme me kërkesën siç kërkohet në dosjen e tenderit, konkretisht me diplomë minimale bachelor në fushat e IT. Prandaj, sipas vlerësimit të ekspertit, OE ankues nuk e ka plotësuar këtë kërkesë të DT.

-Lidhur me kërkesën e DT “Specialist i Sistemeve IT me një eksperiencë minimale prej 10 vitesh në projekte të ngjashme, i certifikuar në Menaxhimin e Sigurisë dhe Sistemeve për Windows, ose Linux dhe me diplomë minimale bachelor në fushat e IT”, eksperti vlerëson se OE ankues nuk e ka përmbushur kërkesën përkatëse të dosjes së tenderit për faktin se nuk ka dorëzuar çertifikatën specifike për Windows apo Linux siç është specifikuar në kërkesën e dosjes së tenderit. Për faktin se çertifikata e ofruar për ndjekje të trajnimit në Cyber Security Network në vitin 2018 nga Ajdin Ukara nuk përmbush kërkesat e përcaktuara për një diplomë bachelor në IT si dhe nuk dëshmon një specifikim për çertifikimin specifik në Windows, ose Linux. Prandaj, sipas vlerësimit të ekspertit, OE ankues nuk e ka plotësuar këtë kërkesë të DT.

-Lidhur me kërkesën e DT “Administrator i rrjetit me një eksperiencë minimale prej 8 vitesh në projekte të ngjashme ose në projekte IT me kompleksitet të ngjashëm, minimalisht i certifikuar në CCNP ose ekuivalent dhe me diplomë minimale bachelor në fusha IT”, eksperti vlerëson se diploma e ofruar nga OE ankues (Diplomë për Specialist profesional në teknologji informative për Marko Marisic), nuk përmbush kriterin e një diplome bachelor në IT, pasi ka vetëm 123 kredi, që sipas sistemit të Bolonjës nuk përbën diplomë bachelor (180 kredi). Për më tepër kjo diplomë nuk mund të konsiderohet ekuivalente dhe/ose e barasvlefshme me kërkesën siç kërkohet në dosjen e tenderit, për faktin se nuk përmban të njëjtat aftësi dhe njohuri specifike si një çertifikatë CCNP. Kurse sa i përket pohimit të OE ankues se kjo diplomë është e nivelit më të lartë se bachelor, eksperti shqyrtues sqaron se në bazë të nenit 59.4 të LPP-së operatorët ekonomik janë të obliguar të ofrojnë dëshmi në përputhje me formulimin e kërkesës së dosjes së tenderit, për faktin se dokumentet tjera apo pohimet e OE-ve për interpretimin e tyre nuk mund të mbizotërojnë dhe dominojnë mbi kërkesat mbi kërkesat e DT, e cila përbën dokumentin kyç dhe udhëzues të prokurimit bazuar në objektin e prokurimit. Prandaj, sipas vlerësimit të ekspertit, OE ankues nuk e ka plotësuar këtë kërkesë të DT.

-Lidhur me kërkesën e DT “Dy (2) Ekspertë Rrjeti me një eksperiencë minimale prej 8 vitesh në projekte të ngjashme ose në projekte IT me kompleksitet të ngjashëm, minimalisht të certifikuar në të paktën një Certified Sigurie CCNP dhe një CCNP Datacenter Certified ose ekuivalent dhe me diplomë minimale bachelor në fusha të IT”, eksperti vlerëson se OE nuk ka dorëzuar asnjë certifikim për dy personat e paraqitur në listë (Abdic Anes dhe Tarik Demirovic), dhe se në kontekstin ligjor mungesa e dokumentacionit të kërkuar dhe certifikimeve specifike bën që OE të mos përmbushë kërkesat e dosjes së tenderit.

- Lidhur me kërkesën e DT “Dy (2) Ekspert për Bazat e të Dhënave me një eksperiencë minimale prej 8 vitesh në projekte të ngjashme ose në projekte IT me kompleksitet të ngjashëm, minimalisht të certifikuar në të paktën Zhvillimin ose Administrimin e DB në platformën që ofron dhe me diplomë minimale bachelor në fushat e IT”, eksperti shqyrtues vlerëson se OE ankues nuk e ka përmbushur kërkesën përkatëse të dosjes se tenderit sepse dëshmia e ofruar, Diplomë Specialist profesional në teknologji informative me 123 kredi për Vedat Vulic dhe Sanjin Elezovic nuk e përmbushë kriterin e kërkesës për një diplomë bachelor e cila sipas sistemit të Bolonjës i ka 180 kredi. Për më tepër, sa i përket pohimit të OE asnkues se kjo diplomë është e nivelit më të lartë se bachelor, eksperti shqyrtues sqaron se në bazë të nenit 59.4 të LPP-së operatorët ekonomik janë të obliguar të ofrojnë dëshmi në përputhje me formulimin e kërkesës së dosjes së tenderit, për faktin se dokumentet tjera apo pohimet e OE-ve për interpretimin e tyre nuk mund të mbizotërojnë dhe dominojnë mbi kërkesat mbi kërkesat e DT, e cila përbën dokumentin kyç dhe udhëzues të prokurimit bazuar në objektin e prokurimit. Prandaj, sipas vlerësimit të ekspertit, OE ankues nuk e ka plotësuar këtë kërkesë të DT.

-Lidhur me kërkesën e DT “Dy (2) zhvillues të lartë me një eksperiencë minimale prej 8 vitesh në zhvillimin e produkteve të ofruara RIS dhe PACS në projekte të ngjashme ose në projekte IT me kompleksitet të ngjashëm, minimum të certifikuar për zhvillimin dhe administrimin e sistemeve në platformën që ofron dhe me diplomë minimale bachelor në fushat e IT.”, eksperti vlerëson se OE ankues nuk e ka përmbushur kërkesën përkatëse të dosjes se tenderit për faktin se dokumentacioni i ofruar nga OE ankues (Diplomë Specialist profesional në teknologji informative për Nijaz Hajderovic) nuk përmbush kriterin e diplomës bachelor, rrjedhimisht nuk e plotëson këtë kërkesë të dosjes së tenderit. Prandaj, sipas vlerësimit të ekspertit, OE ankues nuk e ka plotësuar këtë kërkesë të DT.

-Lidhur me kërkesën e DT “Së paku tetë (8) anetar, te ndarë ne katër (4) ekipe implementuese, me një eksperiencë minimale prej 5 vitesh në projekte të ngjashme, me diplomë minimale bachelor në fushat e IT.”, eksperti vlerëson se OE ankues nuk e ka përmbushur kërkesën përkatëse të dosjes se tenderit për faktin se OE ankues nuk ka dorëzuar asnjë dokument (CV, diplomë, certifikime) për personin Glauk Hoxha të cilin e ka paraqitur në listë, prandaj mungesa e dokumentacionit për një nga stafin e kërkuar e bën që OE të mos përmbushë kërkesat e dosjes së tenderit.

Ndërsa, sa i përket pohimeve tjera që ndërlidhen me këtë pretendim në raport me dilemat dhe interpretimin e terminologjisë apo formulimit të kërkesave të dosjes së tenderit, duke ju referuar shkresave që janë pjesë e kësaj lënde, eksperti shqyrtues vlerëson se këto pohime janë të pabazuara, për faktin se siç e vërtetojnë shkresat e lëndës (përgjigje dhe sqarime shtesë për OE nga AK sipas shkresës së dt. 09.01.2024 dhe dt. 30.01.2024) AK-ja duke ju përgjigjur kërkesave me shkrim të OE-ve ka dhënë sqarime dhe informacione shtesë lidhur me aspektet e tenderit që janë të nevojshme për OE për përgaditjen dhe dorëzimin e një tenderi të përgjegjshëm. Shihni ju

lutem përgjigjet me shkrim nga ana e AK-së nga dokumentacioni i prokurimit. Në këtë kontekst, eksperti shqyrtues sqaron se gjithnjë mbetet nën përgjegjësinë e secilit OE që t'i sqarojë me kohë dhe në fazën paraprake para ofertimit të gjitha dilemat lidhur me kërkesat e vendosura nga AK-ja në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë në kuptim të nenit 53 të LPP-së, apo sipas bindjes së tij/sajë të lirë ti kontestoj ato përmes vënies në lëvizje të mjeteve juridike në kuptim të nenit 108/A paragrafi 3.1 të LPP-së, rrjedhimisht nenit 60 paragrafi 1, shkronja b) të Rrpp nr. 001/2022. Kurse pas pranimit të kushteve dhe kriterëve të vendosura në DT sikurse në rastin konkret, OE ankues dhe secili OE tjetër që ka aplikuar në këtë tender, ka qenë përgjegjës që me kohë t'i parashtrijë të gjitha dëshmitë relevante dhe t'i plotësojë kushtet dhe kërkesat e dosjes së tenderit në përputhje me kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit që të përgadisnin një tender të përgjegjshëm, duke kontribuar në një proces të rregullt në pajtueshmëri me nenin 1 të LPP. Ngase OE ankues në asnjë rrethanë nuk mund të justifikojë mosplotësimin e kërkesave të DT apo papërgjegjshmërinë e tij në dëm të AK ose palëve tjera, pasi kjo bie në kundërshtim me qëllimin e këtij ligji dhe parimet themelore të LPP.

Nga ky konteskt i përshkruar si më lart, eksperti shqyrtues vlerëson se OE ankues në ofertën/tenderin e tij nuk ka dëshmuar se i plotëson kërkesat minimale dhe të domosdoshme lidhur me stafin profesional të parashtruar në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, si kusht qenësor që përcakton se, tenderi do të konsiderohet i përgjegjshëm vetëm nëse është në pajtueshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruar në njoftimin e kontratës dhe dosjen e tenderit. Për këto arsye, Eksperti shqyrtues konstaton se ky pretendim është i bazuar.

- Vlerësimi përfundimtar i ekspertit shqyrtues -

Duke pasur në konsideratë arsyet e eliminimit të cilat AK-ja e përmendi në raportin e vlerësimit dhe në letrat standarde për tenderuesin e eliminuar në raport me pohimet ankimore të OE ankues dhe nga ana tjetër duke i analizuar shkresat e lëndës gjithnjë në tërësinë e tyre dhe duke u mbështetur në dispozitat e LPP-së si ligj material i zbatueshëm si dhe legjislacionit dytësor për prokurim publik, duke i pasur parasysh gjetjet dhe sqarimet e lartcekura, vlerësimi përfundimtar i ekspertit shqyrtues është se pretendimet e OE ankues janë pjesërisht të bazuara sa i përket pikës së parë të eliminimit (Formularit të paraqitjes së tenderit në e-prokurim) por që nuk kanë ndikim në rezultatin e aktivitetit të prokurimit në raport me ankuesin OE “Virtuo O.P”. Për faktin se lidhur me pikën tjetër të eliminimit (për mosplotësimin e kërkesave së kapacitetit profesional) është gjetur se ekziston i bazuar arsyetimi AK-së për eliminimin e tij për faktin se ankuesi OE “Virtuo O.P” së bashku me grupin që kanë ofertuar, ka dështuar t'i ofrojë të gjitha dëshmitë e kërkuara dhe t'i plotësojë kërkesat e kapacitetit profesional në përputhje me kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale të vendosura në pikën 9.1 & 9.2 të FTD së dosjes së tenderit dhe në përputhje me nenin 69 të LPP.

Prandaj bazuar në të lartcekurat dhe dispozitat relevante të LPP që parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, eksperti shqyrtues konsideron se pohimet ankimore në këtë rast nuk përbëjnë bazë të mjaftueshme që aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim në raport me ankuesit tjetër dhe grupin me të cilin kanë ofertuar, duke qenë se eliminimi i tij nga procesi i prokurimit është bërë në përputhje me nenin 59 dhe nenin 69 të LPP.

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Botek” shpk Eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/0703 ka vlerësuar se: - Përmbledhje e përshkrimit të rrethanave procedurale të aktivitetit -

Me 29.11.2023, Ministria e Shëndetësisë, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi, implementimi dhe mirëmbajtja e sistemit Packs dhe RIS të SISH” numër prokurimi 206-23-13309-1-1-1, sipas të cilit dita e fundit e afati i fundit për dorëzimin e ofertave ka qenë data 01.02.2024. Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 3,800,000.00 €.

Kurse me datë 18.07.2024, ka komunikuar përmes istemit elektronik të prokurimit Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – B58 për anulim të aktivitetit të prokurimit të cituar si më sipër. Këtij vendimi iu janë bashkëngjitur edhe letrat standarde për tenderuesit e eliminuar, pjesëmarrës në këtë aktivitet.

Me 23.07.2024, GOE “Vepro AG & Botek” kishte parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të njëjtë të AK-së, të cilën AK e ka refuzuar si të pa bazuar me Vendimin e AK të datës 26.07.2024.

Me 02.08.2024, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar (në sistemin elektronik) ankesën e operatorit ekonomik “Botek Sh.p.k.” (evidentuar me numër protokolli 703/24), kundër vendimit të cituar si më sipër të AK.

-Vlerësimet dhe gjetjet e ekspertit shqyrtues lidhur me ankesën e OE Botek Sh.p.k. -

Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ngritura në ankesën e operatorit ekonomik të cekur më sipër dhe me këtë rast konform vlerësimit të pavarur dhe profesional sipas përgjegjësive të tij ligjore në kuptim të nenit 113 dhe 114 të LPP-së lidhur me nenin 17 dhe 19 të Rregullores, paraqet vlerësimet dhe të gjeturat si në vijim:

Bazuar në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar, eksperti sqaron se, ankuesi OE “Botek Sh.p.k.” është eliminuar nga procesi i prokurimit me arsyetimin se nuk e ka plotësuar formularin e paraqitjes së tenderit në platformën elektronike (e-prokurim) ashtu siç është kërkuar në dosjen e tenderit, duke ju referuar pjesës në nenin 31.1 të Kriteret e dhënies (tenderi i përgjegjshëm ekonomikisht më i favorshëm..) ku ishte kërkuar nga OE që gjate përgatitjes së formularit të tenderit në platformën elektronike, të plotësojnë të gjitha nen-kriteret e TEMF, në të kundërtën, mosplotësimi i formularit të tenderit si duhet do të shpije në eliminim të tenderit. Në të njëjtën Letër, AK e ka informuar OE ankues se i njëjti nuk i ka plotësuar konform kriterëve të dosjes së tenderit kërkesat e kapacitetit profesional lidhur me një pjesë të stafit që janë prezentuar në listën e stafit, duke dhënë një arsyetim konkret për secilin veç e veç se pse nuk e ka plotësuar kërkesën përkatëse të dosjes së tenderit. Shihni ju lutem pjesën e arsytimit nga letra standarde e lartcekur “Në raste të tilla, nga perspektiva e sistemit të prokurimit elektronik OE patjetër duhet të plotësojnë kolonën "Vlera e tenderit", meqenese nuk mund të kalojnë në hapin tjetër, dhe në lidhje me kete si shërbim i helpdeskut gjithmone udhezojme OE që në fushat e vleres së tenderit të peshkruajn vlerat e koeficienteve të peshimit.”

Ankuesi (me të dhëna si më sipër) ka atakuar vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim me arsyetimin se AK-ja nuk i ka trajtuar pretendimet e tij/sajë sipas nenit 108/A pika 12 të LPP-së, duke mos thënë arsyeime konkrete në pretendimet e tij të kërkesës për rishqyrtim. Konkretisht ankuesi ka atakuar vendimin vendimtar të AK për anulimin e aktivitetit të cituar si më sipër nga aspekti i eliminimit të të tij/sajë vendimtar, në pretendimin e parë lidhur me mosplotësimin siç thuhet të formularit të paraqitjes së tenderit në e-prokurim, dhe në pretendimin

e dytë të specifikuar në katër nënpika lidhur me atakimin e arsyetimit të dhënë në letrën standarde për eliminimin e tij për shkak të mosplotësimin e kriterëve të stafit profesional sipas kërkesës së kapacitetit teknik dhe/ose profesional të dosjes së tenderit, për të cilat eksperti shqyrtues konsideron se nuk ka nevojë që të njëjtat të përshkruhen në detaje ose më gjerësisht në këtë rast, por do të prezentohen shkurtimisht për nevojat e vlerësimit të ekspertizës përdorues të njëjtat në aspektin e tërësishëm janë përshkruar në pjesën përkatëse të lartcekur të kësaj ekspertize. Andaj duke u bazuar në përshkrimin e pretendimeve ankimore, eksperti shqyrtues sqaron se kemi gjetur se ankesa bazohet në dy çështje kryesore:

- 1) eliminimin për mosplotësimin siç duhet të formularit të paraqitjes së tenderit në e-prokurim, dhe
- 2) eliminimin për mosplotësimin e kërkesave të kapacitetit teknik dhe/ose profesional lidhur me stafin profesional.

Eksperti shqyrtues, pasi i ka krahasuar të gjitha pohimet e pretendimeve ankimore në aspektin analitik në raport me arsyet e eliminimit të tij/sajë, dhe nga ana tjetër duke e analizuar dosjen e tenderit si dhe dokumentet me të cilat ka ofertuar ankuesi si GOE në raport me kushtet dhe kërkesat e dosjes së tenderit dhe të gjitha shkresat tjera në tërësinë e tyre, gjithashtu duke ju referuar dispozitave përkatëse të LPP-së dhe legjislacionit dytësor për prokurim publik, eksperti jep konstatimin dhe vlerësimin e tij sipas arsyetimit të detajuar si poshtë.

Pretendimi i parë (I): Lidhur me atakimin e vendimit të AK për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim i dt.26.07.2024, OE ankues pretendon se AK-ja nuk i ka trajtuar pretendimet e tij/sajë sipas nenit 108/A pika 12 të LPP-së, duke mos thënë arsye të konkretë në pretendimet e tij të kërkesës për rishqyrtim.

Vlerësimi i ekspertit shqyrtues lidhur me pretendimin e parë (I): Eksperti shqyrtues, pas analizimit dhe vlerësimit të pohimeve të OE ankues në raport me vendimin e AK-së për refuzimin si të pabazuar të kërkesës për rishqyrtim të OE ankues Botek Sh.p.k. dhe të tjerëve, duke u mbështetur në dispozitat relevante të LPP-së si ligj material i zbatueshëm, legjislacionit dytësor për prokurim publik, Rrpp nr. 001/2022, ka gjetur se qëndron i bazuar pretendimi i OE ankues, për faktin se AK-ja nuk ka arritur ta arsyetojë dhe argumentojë me fakte shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi si dhe cila ka qenë baza ligjore ose dispozita adekuate e zbatueshme në të cilën i bazon konstatimet e përgjithësuara në vendimin për refuzimin si të pabazuar të kërkesës për rishqyrtim të ankuesit OE Botek Sh.p.k. për faktin se nuk ka bërë një vlerësim konkret dhe nuk ka paraqitur qartë dhe në mënyrë të plotë arsyetimet lidhur me pretendimet e ngritura nga OE ankues në kërkesën për rishqyrtim edhe pse AK-ja është dashur që të paraqet një arsyetim të plotë dhe të qartë në vendimin e marrë. Prandaj eksperti shqyrtues vlerëson se një arsyetim i tillë i përgjithësuar dhe paprovuar është në kundërshtim me nenin 108/A par. 12 i LPP-së.

Pretendimi i dytë (II): Lidhur me arsyen vendimtare të eliminimit të tij në të cilin thuhet, “nuk e keni plotësuar siç duhet formularin e paraqitjes së tenderit në e-prokurim” duke ju referuar situatës të kriteret e dosjes së tenderit të neni 31. 1 në dosjen e tenderit, OE ankues pretendon se si GOE e kanë plotësuar siç duhet Formularin e paraqitjes së tenderit në e-prokurim ashtu siq është e paraqitur në platformën elektronike të prokurimit duke ndjekur hapat e procedurave të sistemit elektronik.

Vlerësimi i ekspertit shqyrtues lidhur me pretendimin e dytë (II): Eksperti shqyrtues, pas analizimit dhe vlerësimit të pohimeve të OE ankues në raport me dosjen e tenderit dhe dokumentet me të cilat ka ofertuar së bashku anëtarët tjerë të GOE, të cilat mund të verifikohen lehtësisht nga dokumentacioni i prokurimit në e-prokurim, duke u mbështetur në dispozitat relevante të LPP-së si ligj material i zbatueshëm, legjislacionit dytësor për prokurim publik, Rrpp nr. 001/2022, ka gjetur se qëndron i bazuar pretendimi i OE ankues, për faktin se gjetjet tregojnë se OE ankues e ka plotësuar formularin e paraqitjes së tenderit në e-prokurim ashtu siç është përcaktuar në dosjen e tenderit të Kriteret e dhënies (tenderi i përgjegjshëm ekonomikisht më i favorshëm i përcaktuar sipas kriterit të peshës së nën-kritereve të përshkruara Aneksin 6) të nenit me nr. 31.1 të DT, duke ja mundësuar AK-së për të pasur njohuri të sakta për vlerësimin e ofertës të OE ankues pa kërkuar informata shtesë.

Ky konstatim i ekspertit shqyrtues mund të konfirmohet përmes dokumenteve relevante të dosjes së OE ankues lidhur me kriteret dhe nënkriteret e TEMF për dhënien e kontratës që i referohen Aneksit 6 të dosjes së tenderit përfshirë edhe ofertën financiare. Krahas këtyre, vlerësimi i ekspertit shqyrtues në kontesktin analitik mbështetet edhe në bazë të interpretimit ligjor të KRPP të dt. 18.07.2024 dhe dt. 22.07.2024 që ju ka ofruar OE ankues për situatën dhe aktivitetin njëjtë. Shihni ju lutem pjesën e shkoqitur nga interpretimi i KRPP-së: “Ne raste të tilla, nga perspektiva e sistemit të prokurimit elektronik OE patjetër duhet të plotësojnë kolonen "Vlera e tenderit", meqenese nuk mund të kalojnë në hapin tjetër, dhe në lidhje me kete si shërbim i helpdeskut gjithmone udhezojme OE qe ne fushat e vleres se tenderit te pershkruajn vlerat e koeficienteve te peshimit.”

Për më tepër eksperti shqyrtues sqaron se sipas legjislacionit të prokurimit publik duke përfshirë edhe Manualin për OE – Përgaditja dhe dorëzimi i ofertës, i publikuar në uebfaqe të KRPP-së, nuk parasheh informata, shpjegime/udhëzime dhe karakteristika të tilla funksionale të tilla (dëshirueshme) të plotësimit të formularit siç aludon AK-ja, duke qenë se këto kriteret dhe nën-kriteret relevante për lëndën e kontratës që përcaktohen me peshë sipas rëndësisë së tyre relative, përmbushen ose jo me dokumente specifike si në rastin konkret.

Prandaj duke u nisur nga ky vlerësim analitik i shpjeguar si më lart, eksperti shqyrtues vlerëson se arsyetimi i eliminimit në këtë pikë i dhënë në letrën standadre për OE ankues nuk është në përputhje me nenin 59 të LPP-së dhe dispozitat tjera relevante të këtij ligji dhe legjislacionit dytësor të prokurimit publik që parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, për faktin se nuk është në interes të parimeve të ligjshmërisë të LPP-së të përcaktohen praktika të gabuara duke bërë zbatim jo adekuat të ligjit.

Për këto arsye, eksperti shqyrtues konstaton se ky pretendim është i bazuar.

Pretendimi i tretë (III): Lidhur me arsyen e dytë të eliminimit për shkak të mosplotësimit të Kërkesave mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale lidhur me stafin profesional, OE ankues përmes pohimeve të specifikuara në 10 pika të kësaj ankese përkitazi me dëshmitë për stafin e ofruar, pretendon se i kanë përmbushur kërkesat konform dosjes së tenderit.

Vlerësimi i ekspertit shqyrtues lidhur me pretendimin e tretë (III): Eksperti shqyrtues, pas analizimit dhe vlerësimit të pohimeve të OE ankues në raport me dosjen e tenderit dhe dokumentet me të cilat ka ofertuar së bashku anëtarët tjerë të GOE, të cilat mund të verifikohen lehtësisht nga dokumentacioni i prokurimit në e-prokurim, ka gjetur se nuk qëndron i bazuar pretendimi i OE ankues, për faktin se gjetjet tregojnë se oferta/tenderi i paraqitur nga OE ankues

nuk i ka përmbushur kriteret minimale dhe të nevojshme të kapacitetit teknik dhe/ose profesional të parashtruara në kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, për shkak se dokumentacioni i ofruar nga OE ankues nuk përputhet me kriteret e specifikuar në secilën nga kërkesat kërkesat/dëshmitë e kërkuara dokumentare të kriterit të lartcekur (kapacitetit profesional) të dosjes së tenderit. Nga ky aspekt, eksperti shqyrtues konstaton se arsyeja e eliminimit në këtë pikë qëndron pasi që vlerësimi i ofertës së tij është bërë në përputhje me nenin 59 të LPP-së dhe legjislacionit dytësor për prokurim publik, në përputhje me nenin 40 të Rregullorës për Prokurimin Publik nr. 001/2022, për faktin se oferta/tenderi i OE ankues nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat e parashtruara në dosjen e tenderit, për arsyet e detajuara më poshtë:

-Lidhur me kërkesën e DT “Specialist i Sistemeve IT me një eksperiencë minimale prej 10 vitesh në projekte të ngjashme, i certifikuar në Menaxhimin e Sigurisë dhe Sistemeve për Windoës, ose Linux dhe me diplomë minimale bachelor në fushat e IT”, eksperti vlerëson se OE ankues nuk e ka përmbushur kërkesën përkatëse të dosjes së tenderit për faktin se nuk ka dorëzuar çertifikatën specifike për Windows apo Linus siç është specifikuar në kërkesën e dosjes së tenderit. Por OE ankues ka ofruar çertifikata tjera për ndjekjen e trajnimit nga Kastriot Fetahaj (ISO/IEC 27032 Lead Cybersecurity Manager; ISO/IEC 27001 Lead Auditor; ISO/IEC 20000 Lead Implementer; ISO/IEC 27001 Provisional Auditor) që kanë lidhje të përgjithshme me menaxhimin e sigurisë dhe sistemeve, por nuk përfaqësojnë dhe nuk dëshmojnë një specifikim për çertifikimin specifik në Windows, ose Linux. Kurse sa i përket pohimit të OE ankues lidhur me ofrimin e çertifikatave tjera, eksperti shqyrtues sqaron se në bazë të nenit 59.4 të LPP-së operatorët ekonomik janë të obliguar të ofrojnë dëshmi në përputhje me formulimin e kërkesës së dosjes së tenderit, për faktin se dokumentet tjera apo pohimet e OE-ve për interpretimin e tyre nuk mund të mbizotërojnë dhe dominojnë mbi kërkesat mbi kërkesat e DT, e cila përbën dokumentin kyç dhe udhëzues të prokurimit bazuar në objektin e prokurimit. Prandaj, sipas vlerësimit të ekspertit, OE ankues nuk e ka plotësuar këtë kërkesë të DT.

-Lidhur me kërkesën e DT “Administrator i rrjetit me një eksperiencë minimale prej 8 vitesh në projekte të ngjashme ose në projekte IT me kompleksitet të ngjashëm, minimalisht i certifikuar në CCNP ose ekuivalent dhe me diplomë minimale bachelor në fusha IT”, eksperti vlerëson se OE ankues nuk e ka përmbushur kërkesën përkatëse të dosjes së tenderit sepse dëshmia e ofruar, konkretisht çertifikata Cisco Networking Academy Advanced Level Instructor për Albert Jasharin me përvojë 15 vjeqare nuk e plotëson kërkesën për çertifikim me CCNP dhe nuk mund të konsiderohet ekuivalente dhe/ose e barasvlefshme me kërkesën siç kërkohet në dosjen e tenderit, për faktin se nuk përmban të njëjtat aftësi dhe njohuri specifike si një çertifikatë CCNP. Prandaj, sipas vlerësimit të ekspertit, OE ankues nuk e ka plotësuar këtë kërkesë të DT.

-Lidhur me kërkesën e DT “Dy (2) Ekspertë Rrjeti me një eksperiencë minimale prej 8 vitesh në projekte të ngjashme ose në projekte IT me kompleksitet të ngjashëm, minimalisht të certifikuar në të paktën një Certified Sigurie CCNP dhe një CCNP Datacenter Certified ose ekuivalent dhe me diplomë minimale bachelor në fusha të IT”, duke pasë parasysh se OE ka ofruar dëshmi konkrete, përkatësisht çertifikatat CCNP për Redon Hasanmetaj dhe Berat Buzuku, përfshirë edhe dëshmitë për çertifikimet e Dardan Sojeva, eksperti shqyrtues vlerëson se OE ankues e ka përmbushur këtë kërkesë të DT.

-Lidhur me kërkesën e DT “Dy (2) Ekspert për Bazat e të Dhënave me një eksperiencë minimale prej 8 vitesh në projekte të ngjashme ose në projekte IT me kompleksitet të ngjashëm, minimalisht të certifikuar në të paktën Zhvillimin ose Administrimin e DB në platformën që

ofron dhe me diplomë minimale bachelor në fushat e IT”, eksperti shqyrtues vlerëson se OE ankues nuk ka ofruar çertifikata specifike për dy ekspertët e lartcekur siç është kërkuar në dosjen e tenderit pavarësisht përmendjes së disa titujve nga CV e ekspertëve. Prandaj ligjërisht, mungesa e dokumentacionit specifik të kërkuar, nënkupton se OE ankues nuk e ka përmbushur këtë kërkesë në përputhje me kërkesën e specifikuar të dosjes së tenderit, situatë e cila çonë në diskualifikimin e ofertës së OE ankues, si e papërgjegjshme.

Ndërsa, sa i përket pohimeve tjera që ndërlidhen me këtë pretendim në raport me udhëzimet e OE ankues se kinse AK-ja e ka të lejuar të kërkojë sqarime shtesë, eksperti shqyrtues sqaron se gjetjet tregojnë se në të gjitha kërkesat, përveç kërkesës për ekspertë të rrjetit, OE nuk ka arritur të përmbushë kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit të nenit 9.1&9.2 të FTD-së për kapacitetin teknik dhe/ose profesional në raport me stafin profesional, siç kërkohet edhe sipas nenit 59.4 dhe nenit 69 të LPP-së si dhe nenit 40.6 të Rrpp nr.001/2022. Në këtë kontekst, eksperti vlerëson se nuk ka pasur asnjë situatë adekuate dhe të justifikueshme ligjërisht për aplikim të nenit 59.2 ose 72 të LPP-së, për faktin se siç e vërteton dokumentacioni i prokurimit që mund të verifikohet nga shkresat e lëndës, OE ka dështuar të ofrojë dëshmitë relevante në përputhje me të gjitha kërkesat e parashtruara në dosjen e tenderit dhe në përputhje me nenin 69 të LPP-së. Gjithashtu, duke u bazuar në shkresat e lëndës, eksperti shqyrtues sqaron se AK-ja duke ju përgjigjur kërkesave me shkrim të OE-ve ka dhënë sqarime dhe informacione shtesë lidhur me aspektet e tenderit që janë të nevojshme për OE për përgaditjen dhe dorëzimin e një tenderi të përgjegjshëm. Shihni ju lutem përgjigjet me shkrim të AK-së (dt. 09.01.2024 dhe dt. 30.01.2024) nga dokumentacioni i prokurimit. Në këtë kontekst, eksperti sqaron se OE ankues në asnjë rrethanë nuk mund të justifikojë mosplotësimin e kërkesave të DT apo papërgjegjshmërinë e tij në dëm të AK ose palëve tjera, pasi kjo bie në kundërshtim me qëllimin e këtij ligji dhe parimet themelore të LPP. Për faktin se gjithnjë mbetet nën përgjegjësinë e secilit OE që t’i sqarojë me kohë dhe në fazën paraprake para ofertimit të gjitha dilemat lidhur me kërkesat e vendosura nga AK-ja në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë në kuptim të nenit 53 të LPP-së, apo sipas bindjes së tij/sajë të lirë ti kontestoj ato përmes vënies në lëvizje të mjeteve juridike në kuptim të nenit 108/A paragrafi 3.1 të LPP-së, rrjedhimisht nenit 60 paragrafi 1, shkronja b) të Rrpp nr. 001/2022. Kurse pas pranimit të kushteve dhe kriterëve të vendosura në DT sikurse në rastin konkret, OE ankues dhe secili OE tjetër që ka aplikuar në këtë tender, ka qenë përgjegjës që me kohë t’i parashtrojë të gjitha dëshmitë relevante dhe t’i plotësojë kushtet dhe kërkesat e dosjes së tenderit në përputhje me kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit që të përgadisnin një tender të përgjegjshëm, duke kontribuar në një proces të rregullt në pajtueshmëri me nenin 1 të LPP.

Për këto arsye, eksperti shqyrtues konstaton se ky pretendim është i bazuar.

-Vlerësimi përfundimtar i ekspertit shqyrtues -

Duke pasur në konsideratë arsyet e eliminimit të cilat AK-ja e përmendi në raportin e vlerësimit dhe në letrat standarde për tenderuesin e eliminuar në raport me pohimet ankimore të OE ankues dhe nga ana tjetër duke i analizuar shkresat e lëndës gjithnjë në tërësinë e tyre dhe duke u mbështetur në dispozitat e LPP-së si ligj material i zbatueshëm si dhe legjislacionit dytësor për prokurim publik, duke i pasur parasysh gjetjet dhe sqarimet e lartcekura, vlerësimi përfundimtar i ekspertit shqyrtues është se pretendimet e OE ankues janë pjesërisht të bazuara sa i përket pikës së parë të eliminimit (Formularit të paraqitjes së tenderit në e-prokurim) por që nuk kanë ndikim në rezultatin e aktivitetit të prokurimit në raport me OE tjerë ankuesë.

Për faktin se lidhur me pikën tjetër të eliminimit (për mosplotësimin e kërkesave së kapacitetit profesional) është gjetur se ekziston i bazuar arsyetimi AK-së për eliminimin e tij për faktin se ankuesi së bashku me grupin që kanë ofertuar, ka dështuar t'i ofrojë të gjitha dëshmitë e kërkuara dhe t'i plotësojë kërkesat e kapacitetit profesional në përputhje me kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale të vendosura në pikën 9.1 & 9.2 të FTD së dosjes së tenderit dhe në përputhje me nenin 69 të LPP.

Prandaj bazuar në të lartcekurat dhe dispozitat relevante të LPP që parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, eksperti shqyrtues konsideron se pohimet ankimore në këtë rast nuk përbëjnë bazë të mjaftueshme që aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim në raport me ankuesin OE "Botek Sh.p.k." dhe grupin me të cilin kanë ofertuar, duke qenë se eliminimi i tij nga procesi i prokurimit është bërë në përputhje me nenin 59 dhe nenin 69 të LPP.

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues "NOVUS" SH.P.K., Eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/0712 ka vlerësuar se: - Përmbledhje e përshkrimit të rrethanave procedurale të aktivitetit -

Me datën 29.11.2023, Ministria e Shëndetësisë, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi, implementimi dhe mirëmbajtja e sistemit Packs dhe RIS të SISH" numër prokurimi 206-23-13309-1-1-1, sipas të cilit dita e fundit e afati i fundit për dorëzimin e ofertave ka qenë data 01.02.2024. Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 3,800,000.00 €.

Kurse me datë 18.07.2024, ka komunikuar përmes sistemit elektronik të prokurimit Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – B58 për anulim të aktivitetit të prokurimit të cituar si më sipër. Këtij vendimi iu janë bashkëngjitur edhe letrat standarde për tenderuesit e eliminuar, pjesëmarrës në këtë aktivitet.

Me datën 22.07.2024 OE "PACS and Workflow System" kishte parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të njëjtë të AK-së, të cilën AK e ka refuzuar si të pa bazuara me Vendimin e AK të datës 26.07.2024.

Me datën 02.08.2024, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar (në sistemin elektronik) ankesën e operatorit ekonomik "OE PACS and Ëorkfloë System" (evidentuar me numër protokollit 701/24), kundër vendimit të cituar si më sipër të AK.

-Vlerësimet dhe gjetjet e ekspertit shqyrtues lidhur me ankesën e OE "OE PACS and Workflow System"- (NOVUS SH.P.K) -

Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ngritura në ankesën e operatorit ekonomik të cekur më sipër dhe me këtë rast konform vlerësimit të pavarur dhe profesional sipas përgjegjësive të tij ligjore në kuptim të nenit 113 dhe 114 të LPP-së lidhur me nenin 17 dhe 19 të Rregullores, paraqet vlerësimet dhe të gjeturat si në vijim:

Bazuar në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar, eksperti sqaron se, ankuesi OE "Virtuo O.P" është eliminuar nga procesi i prokurimit me arsyetimin se nuk e ka plotësuar formularin e paraqitjes së tenderit në platformën elektronike (e-prokurim) ashtu siç është kërkuar në dosjen e tenderit, duke ju referuar pjesës në nenin 31.1 të Kriteret e dhënies (tenderi i përgjegjshëm ekonomikisht më i favorshëm..) ku ishte kërkuar nga OE që gjate përgatitjes së formularit të

tenderit ne platformën elektronike, te plotësojnë te gjitha nen-kriteret e TEMF, në të kundërtën, mosplotësimi i formularit te tenderit si duhet do te shpije ne eliminim te tenderit. Në të njëjtën Letër, AK e ka informuar OE ankues se i njejti nuk i ka plotësuar konform kriteret e dosjes së tenderit kërkesat e kapacitetit profesional lidhur me një pjesë të stafit që janë prezentuar në listën e stafit, duke dhënë një arsyetim të pamjaftueshëm dhe të pambështetur në fakte për stafin që pretendon se nuk e përmbush kërkesën përkatëse të dosjes së tenderit. Shihni ju lutem pjesën e arsyetimit nga letra standarde e lartcekur.

Ankuesi (me të dhëna si më sipër) ka atakuar vendimin e AK për anulimin e aktivitetit të cituar si më sipër nga aspekti i eliminimit të tij/sajë, në pretendimin e parë lidhur me mosplotësimin kinse siç duhet të formularit të paraqitjes së tenderit në e-prokurim, dhe në pretendimin e dytë përmes pohimeve të specifikuara në katër (4) pika të kësaj ankese lidhur me atakimin e arsyetimit të dhënë në letrën standarde për eliminimin e tij për shkak të mosplotësimin e kriteret të stafit profesional sipas kërkesës së kapacitetit teknik dhe/ose profesional të dosjes së tenderit, për të cilat ekspertit shqyrtues konsideron se nuk ka nevojë që të njëjtat të përshkruhen në detaje ose më gjerësisht në këtë rast, por do të prezentohen shkurtimisht për nevojat e vlerësimit të ekspertizës përderisa të njëjtat në aspektin e tërësishëm janë përshkruar në pjesën përkatëse të lartcekur të kësaj ekspertize. Andaj duke u bazuar në përshkrimin e pretendimeve ankimore, ekspertit shqyrtues sqaron se kemi gjetur se ankesa bazohet në a dy çështje kryesore:

-Kundërshtimin e arsyetimit për eliminim kinse për mosplotësimin siç duhet të formularit të paraqitjes së tenderit në e-prokurim, dhe Kundërshtimin e arsyetimit për eliminim kinse për mosplotësimin e kërkesave te kapacitetit teknik dhe/ose profesional lidhur me stafin profesional.

Ekspertit shqyrtues, pasi i ka krahasuar të gjitha pohimet e pretendimeve ankimore në aspektin analitik në raport me arsyet e eliminimit të tij/sajë, dhe nga ana tjetër duke e analizuar dosjen e tenderit si dhe dokumentet me të cilat ka ofertuar ankuesi si GOE në raport me kushtet dhe kërkesat e dosjes së tenderit dhe të gjitha shkresat tjera në tërësinë e tyre, gjithashtu duke ju referuar dispozitave përkatëse të LPP-së dhe legjislacionit detyësor për prokurim publik, vlerëson se pretendimet e OE ankues janë të bazuara, nisur nga fakti se OE ankues i ka ofruar të gjitha dëshmitë që i plotësojnë kushtet dhe kërkesat e vendosura nga AK në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë. Prandaj sipas këtij konteksti të gjendjes faktike, ekspertit vlerëson se anulimi i aktivitetit të prokurimit është bërë në kundërshtim me nenin 62 lidhur me nenin 59 dhe 60 të LPP-së, duke bërë aplikim të gabuar të këtyre dispozitave të LPP si ligj material, dhe për rrjedhojë nuk është zbatuar në mënyrë të drejtë vlerësimi i ofertës të OE ankues që e ka pranuar për aktivitetin e prokurimit në këtë rast.

Kontatimet dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues prezentohen për trajtimin e secilit pretendim veç e veç në mënyrë të detajuar bazuar në arsyet e renditura sikurse vijon më poshtë:

Pretendimi i parë (I): Lidhur me arsyen vendimtare të eliminimit të tij në të cilin thuhet, “nuk e keni plotësuar siç duhet formularin e paraqitjes së tenderit në e-prokurim” duke ju referuar situatës te kriteret e dosjes së tenderit te neni 31. 1 në dosjen e tenderit, OE ankues pretendon se si GOE e kanë plotësuar siç duhet Formularin e paraqitjes se tenderit ne e-prokurim ashtu siq eshte e paraqitur ne platformen elektronike te prokurimit duke ndjekur hapat e procedurave të sistemit elektronik.

Vlerësimi i ekspertit shqyrtues lidhur me pretendimin e parë (I): Ekspertit shqyrtues, pas analizimit dhe vlerësimit të pohimeve të OE ankues në raport me dosjen e tenderit dhe dokumentet me të cilat ka ofertuar së bashku anëtarët tjerë të GOE, të cilat mund të verifikohen

lehtësisht nga dokumentacioni i prokurimit në e-prokurim, duke u mbështetur në dispozitat relevante të LPP-së si ligj material i zbatueshëm, legjislacionit dytësor për prokurim publik, Rrpp nr. 001/2022, ka gjetur se qëndron i bazuar pretendimi i OE ankues, për faktin se gjetjet tregojnë se OE ankues e ka plotësuar formularin e paraqitjes së tenderit në e-prokurim ashtu siç është përcaktuar në dosjen e tenderit të Kriteret e dhënies (tenderi i përgjegjshëm ekonomikisht më i favorshëm i përcaktuar sipas kriterit të peshës së nën-kritereve të përshkruara Aneksin 6) të nenit me nr. 31.1 të DT, duke ja mundësuar AK-së për të pasur njohuri të sakta për vlerësimin e ofertës të OE ankues pa kërkuar informata shtesë. Ky konstatim i ekspertit shqyrtues mund të konfirmohet përmes dokumenteve relevante të dosjes së OE ankues lidhur me kriteret dhe nënkriteret e TEMF për dhënien e kontratës që i referohen Aneksit 6 të dosjes së tenderit përfshirë edhe ofertën financiare. Krahas këtyre, vlerësimi i ekspertit shqyrtues në kontesktin analitik mbështetet edhe në bazë të interpretimit ligjor të KRPP të dt. 18.07.2024 dhe dt. 22.07.2024 që ju ka ofruar një OE tjetër ankues në këtë aktivitet për situatën e njëjtë. Shihni ju lutem pjesën e shkoqitur nga interpretimi i KRPP-së i cili thotë “Ne raste të tilla, nga perspektiva e sistemit të prokurimit elektronik OE patjetër duhet të plotësojnë kolonen "Vlera e tenderit", meqenese nuk mund të kalojnë në hapin tjetër, dhe në lidhje me këtë si shërbim i helpdeskut gjithmone udhezohet OE që në fushat e vlerësimit të tenderit të përshkruajnë vlerat e koeficienteve të peshimit.” Për më tepër eksperti shqyrtues sqaron se sipas legjislacionit të prokurimit publik duke përfshirë edhe Manualin për OE – Përgaditja dhe dorëzimi i ofertës, i publikuar në uebfaqe të KRPP-së, nuk parasheh informata, shpjegime/udhëzime dhe karakteristika të tilla funksionale të tilla (dëshirueshme) të plotësimit të formularit siç aludon AK-ja, duke qenë se këto kritere dhe nën-kritere relevante për lëndën e kontratës që përcaktohen me peshë sipas rëndësisë së tyre relative, përmbushen ose jo me dokumente specifike si në rastin konkret.

Prandaj duke u nisur nga ky vlerësim analitik i shpjeguar si më lart, eksperti shqyrtues vlerëson se arsyetimi i eliminimit në këtë pikë i dhënë në letrën standadre për OE ankues nuk është në përputhje me nenin 59 të LPP-së dhe dispozitat tjera relevante të këtij ligji dhe legjislacionit dytësor të prokurimit publik që parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, për faktin se nuk është në interes të parimeve të ligjshmërisë të LPP-së të përcaktohen praktika të gabuara duke bërë zbatim jo adekuat të ligjit. Megjithatë, edhe sikurse të ishte reale një situatë e tillë dhe të kishte lëshime të vogla eventuale, AK-ja do të duhej të kishte parasysh nenin 59.4 që përcakton se situatat e tilla do të duhej të konsideroheshin jo të rëndësishme pasi që nuk e ndryshojnë kushtin material ose devijime nga karakteristikat, kushtet dhe kërkesat tjera të parashikuara në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit. Për këto arsye, eksperti shqyrtues konstaton se ky pretendim është i bazuar. Pretendimi i dytë (II): Lidhur me arsyen e dytë të eliminimit për shkak të mosplotësimit të Kërkesave mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale lidhur me stafin profesional bazuar në arsyet e renditura (formë tabelore) në letrën standadre për tenderuesin e eliminuar, OE ankues përmes pohimeve të specifikuar në katër pika të kësaj ankese përkitazi me dëshmitë e kontestuara nga ana e AK-së lidhur me stafin e ofruar (Biljana Droshanova, Muhamet Gërxfhaliu, Bahrije Vardari dhe Jadranka Velinska), OE ankues pohon se i ka ofruar të gjitha dëshmitë përkatëse që i plotësojnë kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit duke ju referuar kërkesave të kapacitetit teknik dhe/ose profesional të përcaktuara edhe me dispozitat e nenit 69 lidhur me nenin 59 të LPP-së. Eksperti shqyrtues konsideron se nuk ka nevojë që të njëjtat të përshkruhen në detaje ose më gjerësisht në këtë rast, përderisa të njëjtat në aspektin e tërësishëm janë përshkruar në pjesën përkatëse të lartcekur të kësaj ekspertize. Vlerësimi i ekspertit shqyrtues lidhur me pretendimin e parë (II): Eksperti shqyrtues, pas analizimit dhe vlerësimit të pohimeve të OE ankues në raport me dosjen e tenderit dhe dokumentet me të cilat ka ofertuar së bashku anëtarët tjerë të GOE, të cilat mund të verifikohen lehtësisht nga dokumentacioni i prokurimit në e-prokurim, ka gjetur se, qëndron i bazuar dhe i mbështetur në

fakte relevante pretendimi i OE ankues, pasi që gjetjet tregojnë se oferta dhe dokumentet me të cilat ka ofertuar OE ankues i ka përmbushur plotësisht të gjitha kushtet dhe kërkesat e parashtruara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë, pasi që ka ofruar dokumentacionin konform secilës kërkesë të specifikuar në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë, dhe njëkohësisht e ka plotësuar edhe kriterin vlerësues për dhënien e kontratës sipas nenit 60 të LPP-së. Nisur nga ky kontekst, eksperti shqyrtues vlerëson se arsyetimi i AK-së i përdorur në letrën standarde për eliminimin e OE ankues nuk qëndron dhe si i tillë është bërë në kundërshtim me paragrafin 4 të nenit 59 lidhur me nenin 69 të LPP-së dhe në kundërshtim me paragrafin 1,2, 6 dhe 13 të nenit 40 të Rregullorës për Prokurimin Publik nr. 001/2022. Prandaj sipas vlerësimit të ekspertit shqyrtues ky vlerësim i gabuar i gjendjes faktike dhe aplikimi i gabuar i dispozitave ligjore të lartcekura ka pasur ndikim në anulimin e aktivitetit të prokurimit në kundërshtim me logjikën juridike të dispozitës së nenit 62 të LPP-së. Në vijim paraqes kontaktimet dhe vlerësimet për trajtimin e secilit pretendim veç e veç bazuar në arsyet si vijon më poshtë.

- Lidhur me kërkesën e DT “Menaxher i projektit IT me një eksperiencë minimale prej 10 vitesh në menaxhimin e projekteve të ngjashme, i certifikuar në menaxhimin e projekteve dhe me diplomë minimale bachelor në fushat e IT”, bazuar në dokumentacionin që e ka ofruar OE ankues, eksperti shqyrtues vlerëson se nuk qëndron arsyetimi i dhënë nga AK për eliminimin e OE ankues në këtë pikë, pasi që OE ankues e ka përmbushur në tërësi kërkesën përkatëse të dosjes se tenderit për faktin se ka dorëzuar diplomën siç është specifikuar në kërkesën e dosjes së tenderit. Për faktin se Çertifikata nr. 09/03/53 për studime Bachelor në fushën e Elektronikës dhe Telekomunikacionit e lëshuar nga Universiteti “Ss Cyril and Methodius University në Shkup për znj. Biljana Droshanova, e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit për diplomë bachelor në fushën e IT-së, pasi dëshmon qartë se znj. Biljana Droshanova e ka përfunduar programin akademik në fushën e lartcekur dhe ka fituar titullin apo kualifikimin bachelor ashtu siç kërkohet në dosjen e tenderit. Prandaj kontestimi i kësaj dëshmie nga ana e AK-së që është përdorur si arsyetim për eliminim të OE ankues është i padrejtë dhe në kundërshtim me paragrafin 2 dhe 4 të nenit 59 dhe nenit 72 të LPP-së dhe si i tillë shkel parimin e barazisë i cili garantohet me nenin 7 të LPP-së dhe nenin 4 të RRPP. Për këto arsye, eksperti shqyrtues vlerëson se OE ankues ka ofruar dokumentacionin specifik siç është kërkuar dhe e ka plotësuar këtë kërkesë të DT.

-Lidhur me kërkesën e DT “Administrator i rrjetit me një eksperiencë minimale prej 8 vitesh në projekte të ngjashme ose në projekte IT me kompleksitet të ngjashëm, minimalisht i certifikuar në CCNP ose ekuivalent dhe me diplomë minimale bachelor në fusha IT”, bazuar në dokumentacionin që e ka ofruar OE ankues, eksperti shqyrtues vlerëson se nuk qëndron arsyetimi i dhënë nga AK për eliminimin e OE ankues në këtë pikë, pasi që OE ankues e ka përmbushur në tërësi kërkesën përkatëse të dosjes se tenderit për faktin se ka ofruar numrin e stafit të kërkuar dhe ka paraqitur dëshmitë specifike që plotësojnë kërkesën ashtu iç është specifikuar në kërkesën e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë. Duke ju referuar dokumenteve me të cilat ka ofertuar ankuesi, eksperti sqaron se në lidhje me këtë kërkesë ku AK ka kërkuar vetëm një administrator i rrjetit me përshkrimin si më lartë, OE ankues ka paraqitur dy persona, z. Konkretisht Bojan Nikolovski dhe Muhamet Gërzhaliu si staf shtesë. Në këtë situatë, bazuar në dokumentacionin e ofruar nga OE ankues, personi Bojan Nikolovski dhe dëshmitë e tij dokumentare e përmbushin plotësisht kërkesën e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, andaj sipas vlerësimit të ekspertit shqyrtues është jorelevante dhe pa ndikim çështja lidhur me stafin shtesë (Muhamet Gërzhaliu) të ofruar nga OE ankues pavarësisht se a e plotëson ose jo i njejtë këtë kërkesë. Prandaj, sipas vlerësimit të ekspertit, OE ankues e ka

plotësuar këtë kërkesë të DT dhe NJK me stafin për Bojan Nikolovski.

-Lidhur me kërkesën e DT “Dy (2) Ekspertë Rrjeti me një eksperiencë minimale prej 8 vitesh në projekte të ngjashme ose në projekte IT me kompleksitet të ngjashëm, minimalisht të certifikuar në të paktën një Certified Sigurie CCNP dhe një CCNP Datacenter Certified ose ekuivalent dhe me diplomë minimale bachelor në fusha të IT”, bazuar në dokumentacionin që e ka ofruar OE ankues, ekspertit shqyrtues vlerëson se nuk qëndron arsyetimi i dhënë nga AK për eliminimin e OE ankues në këtë pikë, pasi që OE ankues e ka përmbushur në tërësi kërkesën përkatëse të dosjes se tenderit për faktin se ka ofruar numrin e stafit të kërkuar dhe duke e tejkaluar atë, pasi që ka paraqitur dëshmitë specifike që plotësojnë kërkesën ashtu siç është specifikuar në kërkesën e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë. Duke ju referuar dokumenteve me të cilat ka ofertuar ankuesi, ekspertit sqaron se në lidhje me këtë kërkesë, OE ankues e ka plotësuar këtë kërkesë përmes dokumentacionit të ofruar për personat e paraqitur, z. Genc Jakupi dhe Nikolche Davchevski, gjë e cila është pranuar edhe nga ana e AK-së. Kurse në bazë të gjendjes faktike shihet qartë se personi i paraqitur, znj. Bahrije Vardari është ofruar si staf shtesë përtej kërkesave të dosjes së tenderit, andaj sipas vlerësimit të ekspertit shqyrtues është jorelevante dhe pa ndikim kjo çështje në të cilën AK është thirrur për eliminimin e OE ankues përkitazi me këtë kërkesë. Prandaj, sipas vlerësimit të ekspertit, OE ankues e ka plotësuar këtë kërkesë të DT dhe NJK me stafin z. Genc Jakupi dhe Nikolche Davchevski.

-Lidhur me kërkesën e DT “Së paku tetë (8) anetar, te ndarë në katër (4) ekipe implementuese, me një eksperiencë minimale prej 5 vitesh në projekte të ngjashme, me diplomë minimale bachelor në fushat e IT.”, bazuar në dokumentacionin që e ka ofruar OE ankues, ekspertit shqyrtues vlerëson se nuk qëndron arsyetimi i dhënë nga AK për eliminimin e OE ankues në këtë pikë, pasi që OE ankues e ka përmbushur në tërësi kërkesën përkatëse të dosjes se tenderit për faktin se ka ofruar numrin e stafit të kërkuar dhe duke e tejkaluar atë pasi që ka ofruar dhjetë (10) persona duke ju bashkëngjitur dëshmitë specifike që plotësojnë kërkesën ashtu siç është specifikuar në kërkesën e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë. Kurse në bazë të gjendjes faktike shihet qartë se personi i paraqitur, znj. Jadranka Velinka është ofruar si staf shtesë përtej kërkesave të dosjes së tenderit ku janë kërkuar së paku tetë (8) persona, dhe se sipas ekspertit dokumentacioni i saj e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit pavarësisht faktit se nuk është e domosdoshme për faktin se OE ankues këtë kërkesë e ka plotësuar me stafin tjetër të ofruar prej nëntë personave, një më shumë se sa është kërkuar. Por edhe sikurse hipotetikiqisht të mungonte dokumentacioni përkatës për znj. Velinska, ekspertit vlerëson se kjo do të ishte jorelevante dhe pa ndikim pasi që OE ankues e ka plotësuar mjaftueshëm këtë kërkesë me stafin tjetër të ofruar. Prandaj, sipas vlerësimit të ekspertit, OE ankues e ka plotësuar dhe tejkaluar plotësimin e kësaj kërkesë të DT dhe NJK me stafin e ofruar prej nëntë (9) personave tjerë pa e llogaritur znj. Velinska.

Si përfundim, ekspertit shqyrtues vlerëson se OE ankues i ka përmbushur plotësisht të gjitha kushtet dhe kërkesat e parashtuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë, pasi që ka ofruar dokumentacionin konform secilës kërkesë të specifikuar në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë, dhe njëkohësisht e ka plotësuar edhe kriterin vlerësues për dhënie të kontratës sipas nenit 60 të LPP-së. Prandaj ekspertit shqyrtues vlerëson se oferta dhe tenderi i OE ankues është e përgjegjshme dhe është eliminuar në kundërshtim me paragrafin 4 të nenit 59 lidhur me nenin 69 të LPP-së dhe në kundërshtim me paragrafin 1,2, 6 dhe 13 të nenit 40 të Rregullorës për Prokurimin Publik nr. 001/2022. Për këto arsye, Ekspertit shqyrtues konstaton se ky pretendim në të gjitha pikat është i bazuar.

-Vlerësimi përfundimtar i ekspertit shqyrtues -

Duke pasur mbi këtë gjendje faktike dhe nga shkresat e lëndës, vlerëson se AK, ofertën e OE ankues e ka eliminuar nga procesi i prokurimit duke vepruar në kundërshtim me vet kërkesat e DT dhe në kundërshtim me nenin 59, nenin 60, nenin 69 lidhur me nenin 1,6 dhe 7 të LPP-së si dhe paragrafit 1,2,6 dhe 13 të nenit 40 lidhur me nenin 4 të Rrpp nr. 001/2022. Dhe si rrjedhojë ky vlerësim i gabuar i gjendjes faktike dhe aplikimi i gabuar i dispozitave ligjore të lartcekura në kundërshtim me bazën e parimeve të LPP-së ka pasur ndikim të drejtpërdrejtë në anulimin e aktivitetit të prokurimit në kundërshtim me logjikën juridike të dispozitës së nenit 62 të LPP-së.

Prandaj bazuar në të lartcekurat dhe dispozitat relevante të LPP që parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, eksperti shqyrtues konsideron se pohimet ankimore në këtë rast nuk përbëjnë bazë të mjaftueshme që aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim në raport me ankuesin OE “PACS and Workflow System” në harmoni me nenin 1, nenin 6, nenin 59 dhe nenin 60 të LPP.

Sipas të thënave më sipër, ekspertja shqyrtuese ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të gjitha pretendimet e operatorve ekonomik ankues “Virtuo O.P.” dhe OE “Botek” shpk si dhe “NOVUS” SH.P.K., , Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtues është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Për më tepër konstatimet e ekspertit shqyrtues janë pjesërisht të bazuara edhe në dispozitat përkatëse të LPP dhe RRPP. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorve ekonomik ankues “Virtuo O.P.” dhe OE “NOVUS” SH.P.K., si dhe “Botek” shpk i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit shqyrtues. Me këtë rast Paneli Shqyrtues ka marrë në konsideratë faktet dhe rrethanat e paraqitura në raportin e ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e Operatorv Ekonomik janë pjesërisht të bazuara

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjera, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues dhe mendimi i tij janë të pranueshme dhe se Paneli me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes pa nevojë që të njëjtat të përsëriten sërish.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesat e Operatorve Ekonomik “Virtuo O.P.” dhe OE “Botek shpk”- te aprovohen si pjesërisht të bazuara, mirpo nga te gjeturat ne procedur, dhe siç jane te pershkruara ne raportin e ekspertit shqyrtues oferta/tenderi i tij/sajë janë të papërgjegjshme lidhur me mosplotësimin e kërkesave të kapacitetit teknik dhe/ose profesional të dosjes së tenderit.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik “NOVUS SH.P.K.” te aprovohet si pjesërisht e bazuar.

Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi, implementimi dhe mirembajtja e sistemit Packs dhe RIS te SISH” me nr. të prokurimit: "206-23-13309-1-1-1", të anulohet njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit, dhe lënda të kthehet në rivlerësim. Paneli Shqyrtues duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartpërmendura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës, ankesën e operatorit ekonomik e sheh si pjesërisht të bazuar, duke sugjeruar që aktiviteti i prokurimit në fjalë të rivlerësohet dhe gjatë rivlerësimit AK të veproj në plotni me dispozitat ligjore të LPP-së dhe kërkesat e dosjes së tenderit ,dhe njoftimit për kontratë.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast raporti i ekspertit shqyrtues përbanë bazë që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim duke marrë parasysh pretendimet ankimore te OE ankues “NOVUS SH.P.K.”.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTERIA E SHËNDETËSISË, MINISTERIA E SHËNDETËSISË, MINISTERIA E SHËNDETËSISË**
- **OE - Virtuo O.P., NOVUS SH.P.K., Botek shpk**
- Arkivës së OSHP-së: